

Vlera e njeriut nuk qëndron  
në dijen, por në  
vullnetin e fortë

HERBART.

# Normalisti

## Mbrendija

Prodhimi letrar i shkrimtarëve Arbreshë nuk  
duhet të ndahet nga ay i shkrimtarëve  
Shqiptarë.

Historija e Gjeografija në klasët e fillores.

Mbikqyrja në kohët e dëfrimit.

Mësim' i Jetës.

Anketat në shkencën pedagogjike.

Bisedë historiko-arheologjike. Dodona e Tomorri

Provë Mësimi.

Provë Mësimi.

Dashtnija ndaj librat.

Vajza e ligë.

Randësija e lojës n' edukatën fizike të fëmivët.

Nder vorreza.

Zakoni ? ! ( novelë ).

Luigi Pirandello

Mendime, Shënime dhe 4 faqe Folklorë.

# Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkëncore  
DEL NJI HERË NË MUAJ.

E botojnë nxânësit e Normales

Editor : Harilla Kuçuli '37.

Sekretar . Kol Lekaj '37.

Arkëtar : Jovan Gjerga '37.

## Ndihmësit

Tajar Reovica '38.

Panajot Foto '38.

Koço Mosko '39.

## Drejtimi

E përkohëshmjia "NORMALISTI,"

Shkolla Normale

Elbasan

Dorëshkrimet nuk kthehen.

## Pajtimet :

Për mësues

Copa lek 1.25

Për gjithë vitin fr. ar. 1.50

Për nxânës

Copa lek 1.

Për gjithë vitin fr. ar. 1.

# NORMALISTI

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore

DEL MUAJ PËR MUAJ

E botojnë nxënësit e Normales.

VITI I VIII.

— MARS 1937 —

Nr. 4

## Prodhimi letrar i shkrimtarëve Arbreshë nuk duhet të ndahet nga ay i shkrimtarëve Shqiptarë

o

Dikush, dikur, tue folë mbi prodhimet shkollore, kërkonte që prodhimi i letërsisë s'onë të ndahet në dyshë; ay i shkrimtarëve Arbreshë dhe ay i shkrimtarëve Shqiptarë; unë, për vehten t'eme, nuk kuptoj arsye nat të cilat mund të na shtyen të bëmë një ndamje të fillë; mund të bëmë, po shumë ndamje të tjera në prodhimin letrar t'onin, por jo kurr n'atë t'Arbreshëve e të Shqiptarëve.

Asht e vërtetë se prodhimi letrar i Arbreshëve në pikëpamje të gjuhës, ndryshon nga ay i Shqiptarëve; por edhe gjuha e tyre, e pastrueme prej d'sa barbarizmeve formën e ka krejt shqip, e medje të shqipes së vjetër, të shqipes së vërtetë. Shkrimet e Santorit, arbresh prej Kalabrije e ato të Schiroit prej Siqelie na paraqesin një gjuhë mjaft të kthjellët; kjo ka aqë

barbarizma italjane sa ka edhe ajo e jona sot barbarizma turke, sllave e greke. Në qoftë se gjuha e De Radës na del para me një ndryshim të math me atë t'onën, në qoftë se n'atë ndeshim shumë vështirsina, në këtë ndryshim e vështirsi do të kenë hasë edhe Arbreshët vetë, edhe fshatarët e Maqës, pse De Rada e teproi me të vërtetë, ia kaloi ku'init në fabrikimin e fjalëve: në këtë gja e shtini en'huziasmi që pat për të sjellë shqipen në një gjuhë të natë letrare.

Për të mbrojtë thezën e një ndamjeje të prodhimit letrar t'Arbreshëve nga ay i auktorëve Shqiptarë nuk mund të pranohen si arsye as fryma që përshkon as landa që përmbajnë: Dara me të vërtetë është lark Shqipnis, por n'atë prozën e bukur përmendën namin e stërgjyshëve të vjetër; n'ato vargjet e Darës Plaku Bala lotët për

atdheun e humbun i derdhën, po, i  
 hypun mbi shkrepat e Italis por i  
 drejtue me fëtyrë e zembër kah  
 "Arbri".

De Rada shkruen po, një roman  
 autobiografik, por kreshniku i veprës  
 është "Milosao figlio di un despota di  
 Scutari". Milosao tue pasë besim  
 të plotë në punën e vet thrrret e bër-  
 tet qysh në vjetin 1836, atëhere kur  
 nuk kishin lemun ende as Naimi as  
 Kristoforidhi me shokë, thrrret e bër-  
 tet "Arcri u bë", "Ardhi dit e Arbrit".

Fillimet e letërsisë shqipe nuk janë  
 tjetër veçse përkthime fetare pa asnjë  
 vlefë letrare; vlefë e Buzukut, Budit,  
 Bardhit, Matiangës e Bogdanit qëndron  
 vetëm në pikëpamje ëjuhësore.

Edhe vepra e Varibobës është  
 krejt fetare, por është e para vepër  
 origjinale artistike e jona; prifti i Mbu-  
 satit, me atë prozën që i drejton  
 mbreteshës së Qiejve, me ata vargje  
 që përshkruajnë jetën e kësaj dhe  
 vuetjetet e të Birit, inauguron prozën  
 dhe poezinë origjinale artistike të  
 letërsisë s'onë.

Prapë një arbresh do të jetë ay  
 që do t'inaugurojë letërsinë shqipe  
 laike artistike: vjeti 1836 është një ditë  
 e shenueme për letërsinë t'onë.

Thomni ju të dashurit.

Nd'ëmbël m'ë të puthurit <sup>1</sup>

janë xhevahiret e para të poezisë s'onë  
 idillyke. Këta dy vargje të De Radës  
 pse të ndahen, pse të mos studjohen  
 bashkë me ata të „Dashuria“ të Çajupit?!

Një ndamje e prodhimit t'onë  
 letrar në shkrimtarë Arbreshë e Shqip-  
 tarë nuk ka asnjë kuptim: në histo-  
 rin e elegjis shqiptare vargjet si këta.

Isht e këthohet e para verë.

Zë bota e tërë të përthihet.

Te të lartat majë bora më shkrihet;  
 bulë e burbukje.

Zën e shpërthejën një t'jatër herë.

Disa të bardha, disa të kukje;  
 të vaktës frymë, ç'i zgjon për jetë,  
 Bimët po kjesin të parat fletë;  
 e si të pylli.

Po ngrëhet kënga, po ndihet fylli,  
 vishen me t' gjelbër e kodra e mali;  
 Vjen dallëndysheja. . . Po s' më  
 vjen djali! <sup>2</sup>

të Schiroit do të përmenden bashkë  
 me ato të "Vait", të Çajupit; copat  
 lirike si kjo.

Deshia mir'u një kopilje <sup>3</sup>

Me di si gjall e shkelkiem

Koilorm <sup>4</sup> si trandafilie

Gazullore, gjith hareme <sup>5</sup>

Fakje kukje si gjershia

Çë shërbej tek argalija <sup>6</sup>.

të Santorit do të spjegohen bashkë  
 me ato të Çajupit e të Naimit.

Edhe projekt-programa e Minis-  
 tris s' Arsimit si landë të klasës së fu-  
 ndit të Gjimnazeve cakton letërsinë  
 shqipe qysh nga fillimi deri në ditët  
 t'ona pa përmendë ndonjë farë dalli-  
 mi, ndamje në mes auctorësh Arbreshë  
 e Shqiptarë.

Dr. Ziaudin Kodra.

1 Milosao-IV-Edi. 1847.

2 Canti Tradiz Mino-VIII f. 512-513.

3 Vajzë;

4 Me ngjyrë;

5 Buzëqeshun e plot harë

6 Që punonte n' avlemend. Kjo copë është  
 marrë nga ato "Këmba", të bukura që Santori ka  
 shkrirun "si intermezzi, në veprën e tij "Il Prigio-  
 niero Politico".

# Historija e Gjeografija në klasët e fillores.

Kur flitet për histori e gjeografi në shkollën fillore, kuptohet vetvetiu se flitet për klasët e epërme d. m. th. për klasën e katërt dhe të pestën, mbasi në këto klasë, mësimi i historisë e i gjeografisë bahet sistematikisht dhe me qëllim të caktuem.

Shum arsimtarë të këtyne landëve ndoshta nuk kanë caktue ende as sasin e landës të ktyne dy msimeve, as nuk kanë të qartë qëllimin që ndjekin këto landë në shkollën fillore.

Këjo mbas mejtimit t' onë do të rrjedhin nga dy arsylene: a) Mbasi deri vonë arsimtari nuk ka pasë landën e caktueme nga mungesa e nji programi të koordinuem e të matun mirë b) Nga se shkollat fillore këtu në Shqipni kanë pasë ndërime vjetësh d. m. th. shkolla fillore ka qenë herë gjashtë rendshe, herë katër e herë pesë rendshe. Si do qoftë, qëllimi i jonë këtu nuk asht tjetër veç se me çfaqë mendimin t' onë mbi procedimin dhe mbi zgjedhjen e landës në këto dy msime, i mbështetun dhe mbi idët e disa pedagogve gjermanë.

Sikur dihet, historija ka për qëllim me na dhanë nji pasqyrë qysh nga kohët e kalueme deri në kohët e reja, kështu dhe gjeografija na jep njohuni mbi përshkrimin e tokës në pikpamje të formës, klimës, të prodhimeve, të racave etj. Këto janë qëllime të përgjithshme të këtyne dy landëve, por këto qëllime me kuptimin më të gjanë të tyne, përkufizohen nga gjansija e rrethi si mbas shkollës.

Pra cilët janë qëllimet e këtyne dy landëve në shkollën fillore dhe si do të zgjidhet landa e këtyne dy msimeve?

Deri vonë mësuesi e fillonte nësimin e gjeografisë tue vretun dheun si tansi të përgjithshme nga pikpamja e pozitës, të kufive dhe të madhësis dhe trajtonte po me këtë mënyrë shtet mbas tjetrit, krahinë mbas tjetrës. Në këtë mënyrë mësohej dhe historija, tue fillue nga kohët më të lashta e deri në kohët më të reja, tue i dhanë randsi më fort datëve dhe ngjarjeve luftarake, pa marrë para sysh as interesin e fëmijes as fuqin mendore të tij. Këjo mënyrë shtjellimi të landës asht e përshtatshme për të rritshëm e për nxansit te shkollave të mesme, por kurrsesi për fëmijet e shkollës fillore. Për këto arsye mësuesi duhet me u largue prej rendimit të shkollës së mesme dhe të mendojë se ka përpara fëmijet me fuqi mendore të njomë dhe landa të jetë praktike dhe e vlefshme për jetën e tij të mavonshme. Meumani thotë: zgjedhja dhe shtjellimi i landës duhen me ngjajtë mbas parimeve të fminis; aji që don me qenë edukator duhet pikë së parit me pasë parasysh fëmijet e jo landën.

Dr. E. Weber thotë: Si parim kryesuer pedagogjik theksoj kërkesën që çdo mësim të dali prej intuitës dhe prej konkretës; jeta e vërtetë të jetë baza kryesore e çdo abstrakcioni (prej së njohtunës në të panjohtun). Fatkeqsisht shkolla i asht largue këtij parimi kryesuer me gjithse theksohet përherë kërkesa e intuitës.

Prandej ai farë mësimi që përshtatshëm për shkollën fillore, mbasi nuk asht i lidhun me jetën e fminis edhe pse na nuk do t' u mësojmë fëmijet landë të thatë të nxjerrun prej fletave të librit, por nji gjë të gjallë

**Methoda është ruga më e drejtë dhe më e sigurtë për të arijtur në zbulimin e së vërtetës ose për ta komunikuar kur ajo është e zbuluar.**

PAUL ROUSSELOT.

të nxjerrun nga ndodhjet e vendlindjes së fëmis ose ma mirë me thanë të nxjerrun nga fletët e jetës së përditshme që rrethon fëmin. Fëmit t' onë do të mësojnë në vend të gjeografis dhe të historis, Atdhe dhe Vendlindje; me e njoftë si në pikëpamje gjeografike dhe historike n' atë mënyrë si i u paraqitet në jetën e përditshme.

Çdo veprim mësimuer do t'i përshtatet qëllimit: Po mësoj fëmij shqiptarë për Shqipninë, qi kështu nesër fëmija ta ndijë vehten kombëtar dhe si në shtëpi të vet në çdo kand të Shqipnis. Çdo pyetje në këto mësimë duhet të zgjojë nder fëmi interesë. Ç' mardhanëje ka me mue (me vendlindjen t' eme, me atdheun t' em) këjo pjesë ose ajo pjesë e dheut, këjo luftë, ky popull?

Të gjitha të tjerat, me randësi të dytë dhe qi nuk kanë lidhje të ngushtë me vendlindjen e atdheun e fëmis, lihen për këtë kohë mbas dore.

Pikë së pari fëmija do të njohi vendlindjen e mbasandej dhe atdheun të gjithë, jetën ekonomike të vendlindjes e t' atdheut mbarë. Ai duhet të dijë se në ç' vend t' Atdheut bahet ullini, portokalli, orizi pamuku dhe ku nxirret voj i gurit, thëngjilli i gurit etj, dhe si shkohet n' ato vende ma lehtë tue marrë si piknisje vendin ku banon fëmija. Këto vende dhe krahina me kaq randësi ekonomike duhen me u punue imtësisht e me kujdes.

Këjo mënyrë punimi jep shkas me nxjerrë dhe me shtjellue dhe shum thema të tjera të vlefshme për të pasanue horizontin kulturuer të fëmis. Udhëtimi i jonë ndër këto vende të ndryshme, jashtë shtëpis s' onë, do t' i ngjajë udhëtimit te një tregtari qi kalon prej një krahinë në krahinën tjetër ma t' afërme, qi merr dhe bje prodhime të ndryshme, ose të një udhtari,

qi për këtë arsye ose tjetër, udhëton nga vendi jonë për në një tjetër.

Si mbas rasës mund të merren shembëlla dhe nga lëvizjet shoqnore si p. sh. një udhëtim me automobilin e postës, një konkurs ciklist qi ban shoqnija sportiste etj.

Rasë të tilla msuesi duhet me i vlefshue në mësimin e gjeografis se këto janë konkrete e të gjalla dhe fëmija tregon për këto një interesë të posaçme.

Në këtë mënyrë mësohet ma lehtë dhe ma me gjallni e interesë Atdheu ma i largët. Kështu fëmija mëson të njofti dhe natyrën e tokës s' Atdheut si nga forma tokësore, si nga klima por edhe nga historija, mbasi mësuesi nuk do të mungojë të flasi mbi zakonet, veshjen, banimin, jetesën e këtyne viseve dhe mbi historin e vendit.

Sikurse kuptohet, gjeografija dhe historija do të shkojnë krahas me njena tjetrën. Edhe së fundit mësuesi nuk do të lënë jashtë rasën pa folë edhe mbi bukurin e natyrës s' atdheut, për me përforcue ndër fëmit dashunin për Atdhe edhe ma tepër me zgjue ndër ata ndjenjat dhe gëzim për bukuri të natyrës.

Këjo mënyrë veprimi nuk asht aspak një gjë e pshjtjellueme, as një hap antime-todik qi cenon parimin "nga e afërmja në të largët," "nga e njohtuna në të panjoh-tun." por i jep gjallni mësimin dhe i edukon fëmit me mendue dhe me vëzhgue ma thellë, tue krijue problema të reja. Një kohësisht këto kanë dhe një vlefë praktike, mbasi nuk ia mbushin trunin fëmis me emna dhe me data të thata, por e pajisin me njohuni vërtet të dobishme dhe të vlefshme për vehten e tij e për Atdhe.

A. K.

# Mbikqyrja në kohët e dëfrimit.

Ariège

**Të hymit në themë.**— Rregullorja e shkollave, si orët e paraditës, si ato të pasmesditës, i dan njana prej tjetrës me një dëfrim, që ngjat një të katërtë ore. Ajo i jep me arsye një randësi të madhe kësaj pune, me qëllim që të gjithë, mësues e nxënës, të gëzojnë njëfarë shplodhjeje të shkuarën ndërmjet mësimeve të ndryshme të shkollës.

**Mbikqyrja në kohët e dëfrimit.**— Me gjithë që rregullorja kohët e shkurtëna të dëfrimit i vë nën mbikqyrjen e mësuesit dhe nëpër shkollat me shumë vjetë mësimi i është shumë një kujdes i veçantë kësaj pune, ka mësuesë që e marrin kohën e dëfrimit për një shplodhje me plot kuptimin e fjalës e s'pranojnë një mbikqyrje të fëmijvet nga ana e mësuesit.

Pa pikë dyshimi këta mësuesë kanë formuem për këte punë një mendim, që mundet me dëmtuem rëndë interesat e 'tyne të veçantë edhe edukatën trupore, mendore e morale të nxënësve, që u janë besuem.

**Kohët e dëfrimit e edukata fizike.**— Në shkollë, ku fëmija është i shtërnguem, nën kaqë formë, me ndiemë nevojën e 'tij për të vepruem, loja është lehtësimi i duhur prej njëj pune mendore e po n'at kohë edhe njana prej bazave të të gjithë edukatës së shëndoshë e burrmore.

Në lojat e lira çdo nxënës lavron vetvetiu fuqit e natyrshëme të 'tij: ai shkon ku i don qejfi, ku i pëlqen atij vetë, e, tue u-rrëkë për me dalë më i zoti se të tjerët n'ato ushtrime, për të cilat natyra e ka pajosun më tepër, shkujdeset për të tjerat. Ndoth edhe që më të guximshëmit e më të fuqishëmit të fitojnë në këto ushtrime, kurse të pafuqishëmit e ata me një vendim më të vonë, ose s'fitojnë fare, ase bëjnë përpjekje që e kapërcëjnë fuqin e 'tyne e që janë të damshëme. Arsimtari nuk do të harrojë që është moralisht i përgjegjshëm

për ndodhjet e liga, që prej mungesës së mbikqyrjes mundet me u ardhë nxënësve të 'tij gjatë kohës së dëfrimit n'oborr, e që i përket me i ndaluem fare disa loja, ku guximi svetënohet e këthehet në rrëmbim, edhe fuqija në një të 'tillë shtazore. Gjithashtu kujdesi për edukatën trupore e mendore të nxënësve e detyron rreptë mësuesin, që t'i shtrëngojë të shogëtit e ata që ndizen pa arsye, si edhe nxënësit që ngatërrohen shpejt me shokë, të përzihen me doemos në loja t'organizueme. Edhe atëherë bëhet këjo pyetje interesante:— Mësuesi, a duhet të luejë me nxënësit?—

Një palë mund të mos e mendojnë aspak këte, sepse mësuesi nuk do të mundesh me mbikqyrë me përfundim të mirë krejt nxënësit të shpërndamë nëpër oborr, e se auktoriteti i 'tij në të nxëmit të lojës do të pësonte një svogëlim të math.

Roli i mësuesit është më i gjanë. Vetëm ai duhet ta ketë auktoritetin e duhur për me bënë një zgjedhje ndër lojat, me ndaluem disa nga këto për arsye të tregueme më parë e me u shtimë në mendje të tjera, që do t'i përshtaten më mirë moshës ose skotës së nxënësve, klimës ose stinës.

**Kohët e dëfrimit e edukata morale.**— Të njohunit thellë të karakterit e të shprehivët të nxënësve është për mësuesin kushti kryesuer për me ia qëllue detyrës së 'tij moralëdhënëse. Mirpo, i penguem në klasë e i shtruem nën rregullat e ngushta të disiplinës, fëmija ruhet e nuk shfaqet krejt. Por përkundrazi gjatë kohës së shkurtun të dëfrimeve nxënësit na duken siç janë me të vërtetë e na mundemi me bënë një numër të math e të frytshëm vërejtjesh psikologjike. Loja vetë, e drejtue me mirë, mundet me i ndifë në njëfarë mase formimit të karaktereve. Tue i nxitë nxënësit me u-përzimë njëmi me tjetrin pa asnjë dallim në mes të 'tyne në lojat që bëjnë në

kohë dëfrimi, mësuesi punon kështu e bën që të lejë ndërmjet 'tyne shoqimi i mirë e i shëndoshë i shkollës, prej kah munden me rriedhë, tue vijuem në kët mënyrë, ndjenja të vërteta të miqsis e shprehia për me duruem e me ndihmuem njëni tjetrin, shprehni kaqë e duhun për jetë, për shoqni edhe për familje.

Të gjitha lojat janë më në fund shkollla kuraje, durimi, ligjshëmie e barasie të shpirtit, e roli i mësuesit do të jetë ai që me të vërtetë duhet, gjithashtu të ngajë

aty, t'i kqyri me besim të mirë e me gjithë çillërin e nevojshëme. Auktoriteti që lidhet me fjalën e 'tij, e bën atë arbitër të caktuem për me rregulluem punë të dyshimta e me gjykuem, pa emnuem ndokend kundërshtime e ngatërresa që munden me gjasë.

**Mbyllja.**— E kuptueme kështu, mbikqyrja në kohët e dëfrimit, në qoftë se lyp nga ana e mësuesit vemendje e takt, nuk mundet me qenë, veçse për fitim t'edukatës trupore, mendore e morale të nxënësve të 'tij.

I. SH. '32.

### A. Mazeo

## Nga një përkthim i pa botuar Mësim' i Jetës.

Kto pak rjeshta u kushtohen, posaçërisht mësuesvet të klasës së parë e të dytë, por do të ishte mirë të këndoheshin e t' i kishin parasysh edhe mësuesit e klasave të tjera, andyç edhe ata të shkollave foshnjore.

Nër vizitat e bëra deri më sot kam konstatuar se ky grumbull mësimesh, që përmbledhet në emrin mësim jete a mësim shikimi, është përgjithërisht, mund të themi i lënë pas dore, e atje që bëhet, bëhet shumë keq e plot të meta. Mësim' i jetës po bëhet një mësim fjalësh e po zihet si një mësim i dorës së dytë.

Ka ardhur koha që t' i lëmë lamtumirën atij mësimi, që zhvillohet vetëm në për mjet të fjalës së mësuesit. Është vërtetë se kishte qënë një gabim themelor ay i të paraqiturit e i të shpjelluarit e mësimit në për mjet të fjalës së mësuesit, ku veprimi edukator aratisej nga një anë prej mësuesit, që flet pa pushim e nga ana tjetër nga nxënësi, që si i ngrirë e i mbërthyer mbi banga, me duar lidhur, ri, dëgjon e mbleth fjalë, që nuk i lënë as më të vogëlën vrugë, në ndërgjegjen e tij.

Kjo është metoda "fallco", që përbën shumë aktivitetin edukator, të shumë arsimtarëve përtacë, të tillë, që harxhojnë, kot, si të themi, frymën e tyre.

"Ajo shkollë që i bën nxënësit vetëm të ndigjojnë e të përsëritin, nuk vlen kurrë e ka vlerën e vërtetë një e tillë, që ka për bazë veprimin, të vërtetit e arsyes", thotë Lombardo Radici.

Duhet të kemi parasysh këtë ligjëdidaktike: "Çdo mësim ka me qënë aq më i frytëshme, sa më i math të jetë vrimi i nxënësit". Në gjithë shkollat aktive, ky aksion asht përshtatur gjerësisht në çdo mësim.

Unë, do të isha i mendimit se gjithë shkollat mund të quhen aktive, në qoftë se mësuesi din të lëftojë, në vetvehte metodën e vjetëruarë edhe plogëtinë.

Nxënësi, nuk duhet vetëm të shohë, të dëgjojë e të përsëritë, po duhet e është e domosdoshme të veprojë e gjithënjë të veprojë, gjë, që nuk jam lodhë kurrë, për ta përsëritë e ripërsëritë. Është vërtetë se nga veprimtaria vërshon të prehurit, e mësuesi në këtë rast, duhet të jetë vetëm një udhëheqës, që do të flasë, sa të jetë e mundur më pak. Puna e parë e 'tij është ajo, që ti bëjë nxënësit të veprojnë, pasi kjo asht shënja e parë e shkollave aktive, si i pëlqen t' i quaj Radici.

Në një punë me të vërtetë konkrete, dallohet edhe aktiviteti i shpirtit; qartësisja

e kënaqësija janë jeta e 'tij, d. m. th. me të tjera fjalë veprimi formativ i mësimin.

Nevoja e fëmijës është veprimi, ay gjen kënaqësi e interes, atje ku ka gjallëri, aktivitet e emocion

Besoj se me këto të paka fjalë kam dhënë çelsin e gjithë punës.

Çdo përparim e çdo hap ka për të qënë më i frytëshmë, në qoftë se do të kishte për shkak e për mjet veprimtarin e fëmijvet.

Duhet pra, jo vetëm në mësimin e jetës por për të gjitha mësimet të ndiqet një e tillë metodë; gjithashtu edhe në të zgjedhurit e lëndës duhet të ruhet e të ndiqet një i tillë kri er.

Më mirë pak lëndë, por e zhvilluar mirë e në mënyrë, që të jetë futë në punë në gjithë anët, aktiviteti e veprimtaria e fëmijvet, se një e tillë e shumë, por e shvilluar në për mjet të një të foluri të pa reshtur nga ana e mësuesit.

Ç'farë kanë për të përfutuar fëmijet e klasës së parë, së II e së tretë në qoftë se mësuesi u bën një mësim mbi aparatit digjestiv ? Kurgjë. Do të jetë më mirë pra, që kësi argumentash të mbështjella prej abstrakcionit, të mos qeken fare. Nji i tillë mësim mund të jetë i vjeshëm për klasën e katërtë a të pestë, pasi atyre u premtion koha për të marrë vesh dishka mbi 'të Me gjithë atë më ka takuar rasti, për fat keq, të dëgjoj të përsëriten, si papagal, prej nxanësve të klasave të para, fjalët: esofagë, gabxher, luks, etj, sa do që në ndërgjegjen e 'tyre nuk ka mbetë kurgjë, pasi kurgjë edhe nuk ka hyrë.

Ajo shkollë që mundohet ta ndrojë nxanësin në një maqinë përsëritëse është një shkollë e falimentuar me gjithë metodat e 'saj.

Vlera e shkollës nuk qëndron, pse ajo na fut diçka në kokë, qëkoha më von mundet t'a shdukij, por te zotësija që krijon e fut në shpirtin e fëmijve', për të përparuar e për 'tu përmirësuar më von. Të bëjë, së fundi një krye të qartë, si tho-

të Gabel-i.

Mësuesit që do të interesohen, e që duan të më kuplojnë më mirë, u rekomandoj librin-Mësime didaktike " Lezioni di didattica" të Lombardo Radicit, duke e kënduar e duke e quajtur, si një gjë shijimin e së cilës ka për t'a ndier në fund, do të gjeni në 'të koncepte — më fort në kaptinën institucionet e mësimeve intuitive — që kanë për t'u bërë më të qartë sa munda të them unë në këto pak faqe e që natyrisht nuk kam mundur kurseja t' i shvilloj aq mirë e aq qartë, sa ay.

Ja disa shënime nga të këti libri :

" Çdo shprehje — espression — lind prej njohinivet. T' u kjarojmë ndërgjegjen e fëmijvet e t' u shkoqitim fjalët, pasi të parë, të vrejtur, të gjykuar me saktësi e të folur janë një gjë e vetëme. Duhet të japim një njohni. Në daçim të kemi një shprehje; duhet t' i mbushim fëmijët me impresione — të vrejtur, të daluem e të krahasuem — në daçim të kemi një shprehje të vërtetë. Fjalët vijnë e dalin lirisht, vetëm atëhere, kur të ketë brënda një njohni të fituar më parë. Nuk duhet të besojmë kurrë që fëmija flet, thotë e gjykon — nga veltija e vet e më fjalët e 'tij — në qoftë se nuk asht mësuar më parë të vrejë e të veprojë. Të marrim përsëri Radicin: " A kini parë se çfarë bajnë shumë familje, për shvillimin e forcave spirituale të të vegjilve të tyre ? I lënë të flasin, për të ritur e kompletuar fantazinë. U drejtojnë kujdesin në fakte. I nxjerrin në për shetitje e i çojnë në për vizita, duke u lënë në këtë mynyrë një liri të madhe për të folur e për të shfaqë përshtypjet e veta "

E çuditëshme për vërtetësin e saj është edhe kjo copë e librit të Radicit: " Pse shpesh herë një fëmi, që në familjen e tij e me njerzit e vet flet gjallërisht, në shkollë vjen mjaft ingathët . . . ? Pse shkollla shpesh herë, don që ata vetëm të vrenë në duke iu dhënë zëmër në të folë. U korigion vetëm fjalët po jo edhe intuitën e tyre: kështu

që të ngulitur e të mbërthyer në banka, i detyron që vetëm të ndigjojnë e të përsëritin, që edhe kjo është një tjetër formë e të dëgjuarit, në vënd që t'i bëjë të jetojnë e të lëvizin në jetën e tyre, në jetën e në botën e të gjithëvet. Burg, pra mund të themi e jo shkollë.

“Cila është fusha e këtij mësimi? Është gjithë bota e fëmijvet Fëmija ka një botë të vetën, flet gjithënjë Radici, që është po ajo e jona, por e parë me syt e tyre, sy që shofin shfaqet e jetës, po pa u thelluar në 'të T' i afrohemi, pra e të ndalemi, kur ay ndalet të shohë e të zbulojë ndonjë send; t'i aprovojë gëzimin e kësua zbulose, pse një gjykim e një domethanije më e thellë, kish për të qënë për të indiferente e e mërzitëshme. T' i ndihmojmë në të spiritualizuarit e sendevet, d. m. th. të da-

llojë e të njohij raportin që kanë ato me njerëzit. Më fjalë të tjera ta bëjmë të zotin e jetës, për të cilën tashti ka një njohni të erët e të gjymtë.”

Mësuësi pra, duke vepruar si udhëheqës i fëmijvet, duhet t' i shtijë ata që të vrenë gjërat që syri i pa mësuar i 'tyre kish për ti kaluar pa i parë.

Shënime të tilla m'u dukën të vjetëshme për të raturit e idesë, mbi shpirtin e vërtetë të mësimt të jetës, sa do që kam qënë i shtrënguar t'i përbleth, sa të ishte e mundur më shumë, me gjithë atë, këto shënime janë vetëm nxitje e udhëzime, për ata mësuës që kanë një vullnet të mirë për të bërë diçka, për ata mësuës që duan të thellohen, për hesap të tyre në problemat e ndryshme didaktike.

Hulussi Rubi

## Anketat në shkencën pedagogjike.

Në numurin 2 të Kallndorit 1937 **Normalisti** kërkonte përgjigjen t'ime rreth pyetjes që kishje bënë një anketë mbi punën hartimit e të botueme n'ate revistë.

Para se t'i përgjigjem kësaj thirrjeje due të spiegoj me dy fjalë se ç'është qëllimi i anketavet: Të shumtë janë auktorët që sot në kërkimet shkencore përdorin këte metodë studimi e cila qëndron në një mendim të çfaqun në formë pyetjeje a të drejtë, që kërkon përgjegjen e një sasije kompetentësh. Natyrisht auktori i anketës e përdor këte për subjekte, të cilat ai nuk mund t'i zgjidhi vetëm e që mendimi i të tjerëvet i është i nevojshëm. Ai mund të baje vetëm hipoteza, për kontrollimin a vërtetimin e të cilavevet kërkon pra ndihmën e të tjerëvet. Në këte rast hipotezat e formueme a priori mund të dalin ose krejt të drejta, ose krejt të gabueme, ose pjesërisht të drejta e mund të ndihmojnë në të hartuemit e të tjera hipotezave. Veç kësaj një sasi e madhe pro-

blemash të reja del në shesh në këte mënyrë.

Sikurse në çdo shkencë tjetër ashtu edhe në shkencat pedagogjike, kjo mënyrë studimi, e cila është përhapë më tepër n'Amerikë, ka sjellë përfundime të mira (p. sh. anketat Colings, Thorndike, B. I. E. etj.)

Për t'ardhë nashti në punën e pyetjeje s'ime, më parë due të tregoj se hartimi tipik që kam botue, nuk më ka ngja mue (mbassi edhe s'kam pasë ndonji herë rend të Vtë), por njëj kolegut t'im, i cili ndoshta edhe do të jetë përgjegjë gjër nashti.

Përsa i përket përgjigjes që më kërkon "**Normalisti**," këte nuk e kam bënë edhe nuk mendoje ta bëje, mbassi nuk kishje idë të premë mbi ate subjekt dhe dëshiroje të shijje se deri ku ishin të drejta e të gabueme hipotezat e mija, që kishje bënë përpara, Nuk desha pra të flas a priori, por të bëje një studim mbi lëndën e mbledhun e të çfaqje mbasandaj mendimin t'im

**a posteriori.**

Me qenë se "Normalisti", e gjenë aqë të natyrshëmë që t'i përgjigjem, ja ke po i shënoj hipotezat që pata formue unë:

**a) Shkaku i hartimit të dobët:**

1) Metoda e mësimit të jetës (ndoshta një metodë pyetse e teprueme) dhe më vonë e lëndëve që zävëndësojnë këtë mësim.

2) Mungesa e hartimevet të lira.

3) Teprimi i të folunit horas.

4) Fryma dogmatike përgjithënisht në lëndët e mësimit

5) Disiplina përgjithënisht.

6) Edukata familjare (sidomos parashkollë).

**b) Si me i përmirsue ata nxânës:**

1) Me i shtymë nxânësit me këndue shumë copa të bukura ndër libra a fletore.

2) Me bā bisedime të lira në rend mbi thema të ndryshëmë.

3) Me bā hartime të lira. (Me shkru

seicili 1 a 2 herë në javët mbi ato që e ka interesue atë javë).

4) Me i nxitë nxânësit që të bëjnë mbas çdo mësimi një përmbledhje mbi atë që ka spiegue mësuesi.

5) Me zhvillue sa të jetë e mundur punën ndër grupe.

6) Me formue shoqëni në rend e në shkollë, konferenca, festa etj.

**c) Si duhet të bëhet hartimi?**

Kjo është një çështje mjaft e gjënë, për zhvillimin e së cilës pres përgjigjet e të tjerëve. Vetëm në një mënyrë të përgjithëshme mund të them se para së gjithash duhet një reformë e të gjitha lëndëve të mësimit, e cila do të përmbledhi edhe hartimin. Kjo reformë duhet të bazohet mbi nevojat biologjike e psikologjike të fëmijës si dhe mbi organizimin e jetës shoqënore, parime këto që na përçojnë drejtë shkollës aktive a shkollës së punës.

S. Paparisto.

## Bisedë historiko-arheologjike. Dodona e Tomorri.

Më 15 të Janarit të kaluar në gaz. (Arbënia) Nr. 463, bëhesh fjalë. se rreth Tomorrit të Shqipëris, në V. J. e P. të tij, si mbas historianit Kiepert, në kohën e lashtë gjendëshin qytetet e kështjellat: Godri, Antipatreia, Gorrhagum, Geraunium e Orgessus Për t'u vërtetuar e për të marrë vesh, se sa i drejtë është aji përshkrimi, i kërkova këto emra në fjalorin e Skarlato Bizantini emrat e vjetër të përveçëm dhe pash në faqe 95, se me emrin Korrakon (latin. Gorrhagum) përmendet një kështjellë e vjetër në Maqedhoni dhe jo këtej nga Tomorri; ashtu në f. 88 të këtij fjalori, këndova. se malet e larta midis kufijvet t'Epirit (Toskëris së vjetër) e t'Iliris Maqedhonianë deri n'Adriatik në kohën e lashtë janë qenë quajtur Keravnia (latin. Geraunia), d. m. thën male të rrufës: shënim nga i cili kuptohet, se mbi ndonjë mal nga kë-

ta me emrin Geraunium (jo pran Tomorrit) nga ana e Romakvet a Maqedhonasvet do t'ishte bërë ndonji kështjellë, që përmendet në luftat Maqedhono-Romake. Ashtu prap dhe qytet i vjetër Antipatreia shënohet aty ku është Berati sot, por jo rrëzë Tomorrit. Qyteti Orgessus prej Strabonit, libër IX, kr. V. paragraf. 19, përmendet me emrin Argessa si qytet i Thesalis në L. të Pindit. Kështjella Gadrjo krejt nuk përmendet në fjalorin e lart shënuar, ashtu dhe Straboni nuk bën fjalë për të; punë kjo që kallzon se ajo kështjellë ka qenë ndrequr rastësisht aso kohe dhe se ka qenë pa rëndësi.

Sa për qytetin Dodona e për tempullin e famshëm rrëzë Tomorrit ishte shkruar në Nr. e përmendur t'Arbënis, se këto i zbuloi arheologu Karaponos më 1878 pranë malit Uliçka në J. P. të Janinës e se janë të kota kërkimet pran Tomorrit të Shqipëris. Nuk

është aspak e drejtë kjo përbuzje për Tomorrin t'onë, se shumë historianë e gjeografë të vjetër e thonë vetë për tempullin dhe qytetin e Dodonës, se kanë qenë në veri të Toskëris pran e rrezës Tomorrit të saj dhe si mal me emrin Tomor ky ka qenë dhe është në Toskëri dhe jo të tjerë të shpifur e të pa përshtatur. Libri "Historija e Tomorrit, ka plotë shënime, gojdhana e kallzime dhe të gjitha këto janë në bazë historijanësh të vjetër e në bazë tregimesh të popullsis rrethore të Tomorit t'onë; ka plotë gërmadha andej e këtej Tomorit t'onë dhe ato diçka përmbajnë mbuluar nën ledhet e mëdhaja; nuk janë, jo, të qyteteve e kështjellave që përmenden më lartë, se ato qytete e kështjella kanë qenë në tjera vise dhe jo pran Tomorrit.

Një historijan i kohës së ré. Zoto Molossi, (Athinë 1887), ka shkruar e përmendur se Eneasi, një nga prijësat e luftës së Trojës, i ikur q'andej erdhi n'Amraqi (Arta e sotme pran gjirit t'Amraqis) dhe q'aty dërgoi delegatë për fat-thënë në Dodonë, të cilët për dy ditë tuke shkuar nga veriu vajtën në Dodonë e për dy ditë tjera q'andej u kthyenë në Butrint, ku priste Eneasi i ardhun me flotën e tij.

Ja pra, se si largohet prap tempulli Dodonian nga mali Uliçka që nuk është larg nga Amraqija veç se gjysëm dite ose dhe më pakë. Ku vajtën këta delegatë për dy ditë udhëtim në V. t'Arisë? n'Uliçka? jo; por diku gjetkë; në Tomor të Toskëris, që është në viset veriore të saj

Fier, Shkurt, 1937.

#### Perikli Ikonomi

## Provë mësimi

Dhënë në rendin e V të  
t' Ushtrimoreës, më 3-III 937.

**Lënda:** Histori Natyre

**Thema:** Thëngjilli i gurit, Grafiti e Diamanti.

Dispozicioni:

1 E përdorim për t'u ngrohur.

2 Si është forma e thëngjillit të gurit në

krahasim m'atë të drurit.

3 Kush na e provon se ka qënë drù.

4 Si e nxjerrim në shtresa të pjekura e të cekta, e jo pjekun (linjit Krabe).

5 Reziqet e punës nën dhë.

6 Përdorimi e rëndësia n'industri (shtetet e pasura në thëngjill guri janë të fortë politikisht e ekonomikisht), ngrohemi, katrami, gazi ndriçues, punojnë vaporë dhe fabrika

7 Fisi i tij janë: Grafiti e përdorimi i tij,

8 Diamanti e përdorimi i tij.

## Zhvillim.

Passi të jetë vënë klasa në qetësi e si të jetë mbaruar dhe kontrollimi i pastërtisë, nxitin nxënësit dhe fillon mësimi kështu:

**Hyrja:** Ju të gjithë dini t'i thoni mësuësit: ç'farë lëndë djegëse përdorim për t'u ngrohur? Nx, Ne për t'u ngrohur përdorim drù, qymyr drùri, qymyr guri etj.

**Paraqitja.** Mës. Merr një thëngjill guri në dorë dhe drejtohet nga nxënësit duke folur: mirë se drutë i gjejmë në pyll lehtas dhe qymyrin e drurit e bëjmë vetë, po thëngjilli i gurit si të jetë bërë, thoni, fëmijë? Nxënësit, në qoftë se dinë të flasin, më sa kanë dëgjuar rastësisht mbi thëngjillin e gurit, largen prej mësuësit të flasin dhe për t'i plotësuar njohnit e paka që kanë, u tregon mësuësi si është prodhuar thëngjilli i gurit duke e krahasuar m'atë të drurit dhe më në fund u provon se edhe thëngjilli i gurit është i prodhuar prej drurit.

Mës Në kohra shumë të lashta, të themi më mirë, milione vjet përpara, toka jonë mbulohesh me pyje drurë e të cilëvevet arrinin një gjatësi gjer më 50 60 metro. Mës Pse qenë rritur aqë tepër e sot nuk rriten? Nx. Qenë rritur aqë tepër, pse toka n'ato kohra ka qënë e pasur, ka patur lagështirë dhe atmosfera ka qënë mjaft e nxehtë (kondita të favorshme për zhvillimin e një bime). Të gjitha këto dalin prej nxënësve duke u udhëhequr prej mësuësit. Mës. Mirë po në këto kohra ndodhte dë-

ndur në tokë një gjë, që e ndiejmë ne këtu n'Elbasan kohë pas kohe. Nxënësit me një herë marrin vesh dhe hidhen të thonë: tërmeti Mës. Pra prej tërmeteve të forta n'ato kohra shembeshin male të tërë dhe ç'gja shkakëtohesh nga kjo gjë? Nx. Shumë pyje, me që rrëzoheshin male të tërë, mbuloreshin me tokë ose nga shkëmbenjt e mbëdhenj thyeshin shumë nga lisat e pyjvet dhe ujët e shiravet të mbëdha këto lisa i tërhiqte gjer të qëndronin nëpër fu sha. Mës. Këtu tashti porsi gjithëmonë ujët vazhdonte duke sjellë tokë (alluvione), çdo të bëheshin këto drunj? Nx. Do të mbuloreshin. Mësuesi u-kallzon se shtresat e tokës që u formuan mbi drunjt arrinë një trashësi 200-500 edhe 1000 m. Mës. Tashti duke qënë kështu të mbuluara këto shtresa drunjsh, ç'gjë do të kenë pësuar thoni ju? Në qoftë se disa nga nxënësit mund të thonë se janë kalbur atëhere u dëftan arrësyeen pse nukë janë kalbur dhe se këto kanë pësuar një gjë tjetër; janë djegur në mënyrën që djegim ne drutë kur bëjmë qymyrin e drurit. Tashti mësuesi me rast pyet nxënësit të tregojnë se si bëhet qymyri i drurit dhe si të kenë biseduar pak mbi këtë nxiten prapë të përshkruajnë një copë qymyr guri që po e mban mësuesi në dorë. Mës. Ç'far ngjyrë ka thëngjilli i gurit? Nx. Thëngjilli i gurit ka ngjyrë të zezë, është i rëndë. dërmohet etj. Mës. Ju e shihni që është i përbërë peta peta ç'farë gjë na provon kjo? Nx. Që është peta peta provon se është i prodhuar nga druri. Si të jetë bërë një krahasim midis dy copash thëngjilli, atij të gurit m'atë të drurit, dhe të kenë funduar se thëngjilli i gurit është më i rëndë. thekson mësuesi: me qënë se është i rëndë dhe i fortë posi guri e quajmë "thëngjill guri,.. Me qënë se copa që u dëfthehet nxënësvet është Linjiti dhe jo thëngjill guri në plot kuptimin e fjalës, bëhet një krahasim duke ju thënë se linjiti nukë është aqë i zi, i shkëlqyershëm, dhe i fortë sa është thëngjilli i gurit, i cili gjindet me shumicë n'Angli. Gjermani, Kanada (nëpër ato toka të cilat kanë dalë me

parë prej detit). Linjiti na paraqitet me cilësitë që treguam nga shkaku se nuk ka ndënjur brenda në tokë sa thëngjilli i gurit e të piqej si i dyti. Në këtë kohë pyeten nxënësit të thonë në se kemi apo jo ne ndo një lloj thëngjilli nga këto në vëndin t'onë dhe u theksohet, të dinë, se thëngjilli i gurit që kemi ne si në Krabë ashtu dhe në Mborje të Korçës është " Linjiti .. Nxiten nxënësit të flasin me fantazinë e tyre duke udhëhequr nga mësuesi. Mës. Si nxiret thëngjilli i gurit prej tokës? Nx. Thëngjilli i gurit nxiret duke hapur në tokë puse të thella dhe pastaj gërmojnë në çdo drejtim duke formuar rrugë mbi të cilat shkojnë vagonat që shërbejnë për t'a sjellë qymyrin nga një vënd në tjetrin. Me mijra punëtorë punojnë duke mbajtur nga një dritë përpara se cili, të veshur me roba të ndryshme e me maska në fytyrë. Mës. Po pse vishen kshu e venë maska në fytyrë? Nx. vënë maska për tu mbrojtur nga gazet e ndryshme. Kështu epet një rast të fliten tashti mbi aksidentet që mundë të ndodhin nëpër minierat e thëngjillit të gurit dhe më në fund të theksohet se me gjithë se është e rezikuar jeta e njeriut nëpër mine, me mijra punëtorë punojnë për zhvillimin dhe të mirën e njerëzisë. Mës. Përse e përdorim qymyrin e gurit? Nx. Për t'u ngrohur, nëpër vapore, trena dhe fabrika të ndryshme. Mës. Pra ata shtete që kanë me tepëricë qymyr guri, si duhet të jenë thoni ju të fortë apo të dobët? Nx. Shtetet që kanë thëngjill guri janë të fortë politikisht dhe ekonomikisht pra dhe ne tue pasë linjiti mund ta përdorim siç e përdorin n' Evropë.

Mës Mirë po n' Evropë thëngjillin e gurit e përdorin për të bërë gjellë dhe në vënd të llambavet si mjet ndriçimi, po në një mënyrë tjetër. Bëhet figura e maqinës në tabellë dhe spiegon mësuesi mbi te. Marrim një enë e cila të jetë prej tulle dhe brenda të mos ketë aqër. Brenda në këtë enë venë thëngjillin e gurit dhe poshtë enës i vën zjarrin. Tashti (gazi) që do të prodhohet brënda n'enën shpërndahet nëpër qytet me anë të solinavet

Në vëndin ku del gazi, po të afrojmë një shkrepës me një herë do të ndizet në flakë, e cila ka fuqi ndriçuese dhe fuqi sa të zjenjë gjellë e të shkrinjë metale. Këtë gas e quajmë "gazi ndriçues."

Për të kupëtuar më mirë nuanësit prodhimin e gazit ndriçues mësuesi në këtë kohë u bën një një provë: merr një letër pak të trashë dhe e pshtjell në formë burie, pastaj nga një anë e ndes kurse anës tjetër që lëshon tymin i afëron shkrepësen Tymi me një herë ka për të ndezur. U thohet se po ta përdorim gazin ndriçues për dritë kemi kursim, po mundet të kemi edhe reziqe nga gazi ndriçues. Të mbeturat nga thëngjilli i gurit (kok) u thohet se mund ti përdorim për t'ngrohur dhe nuk mund të na ngasë ndonjë rezik. Për të provuar nuanësit se thëngjilli i gurit përmban katram ngroh mësuesi në zjarr një copë dhe ja afron njerit t' marrë erë, e cila është thjesht era e katramit.

**Fellimi.** Mës. kemi edhe disa minerale të tjera që i afërohen qymyrit të gurit, sikurse është grafiti, të cilin e kini me vete dhe e kini parë që të gjithë. Nx... Përgjigjen: kalemi Flitet cilësitë e këti lloj minerali duke thënë se është në bojë hiri, i butë, kur e kap me dorë të duket si kur të lyen dhe shkruan në letër. Pas cilësivet flitet mbi përdorimin e tij; bëhen kalamat dhe përdoret si lëndë për të veshur shumë maqina e vegla prej metali për të mos u-ndryshkur.

Një lloj thëngjilli i gurit i thjeshtë, po që gjendet shumë rallë, është i shkëlqyer dhe i çmuar, cili është ky thoni? Nx.. Përgjigjen "Diamanti.. Flitet se gjendet në shumë lloj ngjyra, po ay m' i miri është krejt i bardhë Diamanti është shumë i fortë, as një nga mineralet e tjera nuk mund t'a vijonjë. Gjindet n' Indinë e Lindjes, gjat lumenjet t' Uralit, në kepën e shpresës së mirë dhe në Brazili. Diamanti më i math është Culinam. Mës... Përse e përdorin diamantin Nx... Diamantin e përdorim si mjet zhukurimi, nëpër vëthë unaza, bezelike etj. e edhe për të prerë xhamet (elmas).

**Përmbledhja.** Mësuesi cakëton një nxënës të përsëritnjë të gjitha sa u-biseduanë duke i bërë pyetje dhe kështu behet një përmbledhje e lëndës që u-zhvillua.

**Mjete të nevojshme për mësimin.**

Thëngjilli i gurit, linjiti, koku, gazi ndriçues, grafiti dhe diamanti.

**Thodhor Vezuli '37.**

## Provë mësimi

Dhanë në klasën e III të  
t' ushtrimores

Elbasan 8-III-37

**Lânda:** Gjuhë

**Thema:** Vjerrshë "Vjollca,  
Zhvillim

Disa dit përpara nuanësit kishin dalë me shetitë dhe një kandidat i jon' inxori me qëllim qi t' u bante mësim në natyrë përmbi stinë e prandverës dhe shenjat dalluese qi shifen në këtë stinë; ndër këto shenja duet edhe manushaqia, dhe në këtë rastë nx. mbledhin nga një tufë manushaqe.



**Hyrja.**— Mës. Ç' farë bamë një ditë qi duetëm me shetitë? Nx Mës. si i quejmë na ndryshe manushaqet? Nx Mës. Ç' farë na diftojnë vjollcat se po vjen? Nx. Këtu mësuesi fillon të tregojë mbrendia e vjerrshës e cila mund të lehet edhe në të folunit lirishit të nx. tue u nxitë me pak pyetje të mës. Mës. Ç' farë ngjyre kanë vjollcat? Nx. Mës. ku çilin këto? Nx. Mës. po vetëm nëpër hendeqe e ferra çelin këto? Nx. Mës. prâ ndonji herë këto çelin edhe në fushë nën barë të bletë. Mës. Si na duken vjollcat prej së lareu kur i vrejme? (Nxanësit tregoinë disa cilësina morale qi përfaqson vjollca).

Mës. Si e mban kryet vjollca? Nx.— Mës. Prâ si mund t' a quejmë vjollcën me kënë se me mban kryet të krusun dhe nuk vrenë për rreth? Nx. (Këtu mës. me anë të shembujve dhe gjesteve nxjerr se vjollca është e pà krenë dhe nuk mburret). Mës. Përse na sl'ërben vjollca? Nuanësit tre-

gojnë sepse na shërben vjollca tue na dhanë erën, se me ate bahet levandë etj. Mës. Kur i marrim erë vjollcës ç'farë ngjanë në zëmrat t'ona? Nx..... (Këtu tregohet se kurë i marrim erë vjollcës na kënaq dhe na ngushëllon zëmren. Mës. Ç'farë duhet të bajmë na me këto vjollca? Nx... Mës. Na prà duhet qi t'i mbledhim vjollcat nëpër hendeqet dhe ferra dhe t'i mbjellim ndër kopshte dhe oborre t'ona sepse këto janë të bukra.

Mësuesi ndëgjoni këtu: Për vjollcën kemi një vjerrshë të bukur të cilën po e mësojmë tashti të gjithë së bashku.

**Paraqitja** — Përpara po u a thom unë dhe ju ndëgjoni me vemendje e kështu ta mësojmë sa më shpejt. Mësuesi fillon vjershën me e thanë ngadalë tue i theksue fjalët si mbas tonit të duhun.

1) Mësuesi e lexon me zà të mirë.

2) Analizohen strofat me bashk-punimin e nxânësavet.

3) Dallohen idët e përgjithshme tue tregue ate shka kà dasht me thanë auktori dhe të cilave ndienja u është drejtue.

4) Tregohet rreshtimi i idevet si mbas të cilavet auktori. kà dasht me ja mbërrit qëllimit të 'tij.



Mësuesi pastaj u thotë: po u a thom edhe një herë dhe ju më tregoni fjalët qi nuk kuptoni; kështu mës. thotë strofën e parë dhe ju spjegon fjalët, pastaj strofat e tjera tue veprue po kështu. por një kohësisht tue spjegue fjalët mës. i shkruen në drasë të zezë me qëllim qi t'i kuptojnë dhe t'i shqyptojnë më mirë. Me këne se në këtë rasë u bà një shberthim i vjershës mës. e thotë edhe një herë. Si t'jetë mbarue edhe kjo herë tash fillon qi të mësohet edhe prej nx. dhe mës. ju thotë: Unë po ju diktoj rreshtin e parë dhe ju pastaj t'a thoni mbas meje. Mës. fillon rreshtin e parë dhe nx. e ndjekin, po kështu vepron me rreshtat e strofat e tjera. Mbassi të përsëritet kjo në grup ju thotë mës: të shofim a po mundeni me e thanë ju vetëm.

Nx. fillojnë, por edhe kësaj herë ndihmohen prej mës. i cili e thotë me një zà

mà t'ultë se përpara. Qi të përvehtsohet më mirë mësuesi ndanë klasën në dy grupe si mbas radhës së bankave dhe i urdhënon qi njena palë po e thotë një herë pastaj tjetra. Në këtë mënyrë përsëritet një dy herë dhe pastaj mës. ngreh disa nxânësa (ose nxânëse) qi shef se e kanë përvehtsue më mirë të dalin dhe t'a thonë jasht, e mës. me qëllim qi të bajnë nx. me e deklamue më tepër vën në katedër një tuf vjollca tue u kthye nx. prej 'tynë:

**Përmbledhja** — Si t'jenë pá qi është përvehtsue mirë prej nx. dhe tue drasht qi të mos bahet monotone mës. kërkon prej nx. ndonji vjershë tjetër qi kanë mësue më përpara dhe mbassi t'a thonë disa nx. këtë, ora është në mbarim dhe mës. u thotë: të shofim a e kení mbajt mend a po jo vjershën qi mësueme. Nx. e thonë dhe një herë në grup dhe kështu mbaron ora.

## Vjollca

E njomë e blertë,

Nji lulz' e mirë,

Nën bår të blertë.

Kah unë është prirë.

Me krye pak t'ult,

Për bukuri,

Si bijë e urtë

E pa kreni.

Dashtni të msheftë

Ajo m' rrëfen,

Si kúr due vetë,

Si mue m' pëlqen.

Me t' kandshmen erë

Për herë qi lëshon,

Zëmbrën e mjerë

Mue m'a ngushllon.

Fytyr' e sajë

Si hyll qi ndritë,

Asht plot uzdajë

Shpirtin m'a shndritë.

Me rranjë dishroi

Ate më vonë

Në shpí t'a çoj

T'a kemë gjithmonë.

(H. Gjylbegaj)

Me gjithë se kjo vjerrshë është e lehtë nuk mund të mësohen të gjitha strofat në një orë, prandaj mësohen vetëm katër.

Frano Preçi '37.

# Dashtnija ndaj librat.

Edmondo De Amicis.

Sá e madhe áshft fuqija e librave në mirë rritjen e fëmive! Fati i shum njerzve u mvar nga pasja ose mos pasja e nji bibliotke në shtëpinë atnore të tyne. Të patunit për doresh në të gjitha orët e ditës mëndyren si m' i kënaqë kersheritë e para fëminore, me kalue merzinë e ditve të shiut tue shfletue libra, hodhi në shum trú farën e parë të nji dashtnije për studim qi me kohë u-kthye në nji pasion të nxehtë për shkencën e frytzoj, disá fuqi mendore të cilat studimi i detyruem dhe i kufizuem i shkollës do t' i lënte djerr. Tue lanë më nj anë rjedhjet e saja, áshft mirë qi t' ju fusim fëmive adhurimin ndaj librat edhe përpara dashtnisë së të lexuemit. Áshft mirë për fëminë qi të shohi nji kand të shpisë, kú t' i jetë ngrehë si nji altár studimit e dijës, të cilit pá i kuptue akoma shkakun, sheh t' i bahen prej prindve të tij disá kujdesime, dhe të tregohet nji farë nderimi; një dhomë e qetë kú aj herë pas here sheh ndonji njeri të pá luejshëm të vránt; nji vend i kushtuem mendimit, sikurse áshft nji i kushtuem punës dhe nji tjetër pushimit. E si djalë do të këndoje me andje të vëcantë ato libra me të cilat i kje mësue syni qyshë në fëminë, q' i ká pá mija herësh të rregullohen, të pastrohen e të pekëdhelen nga prindët e tij, qi kishin për të secili simbas formës e njerës së tij nji domethanje fantastike dhe përpara se të njipte alfabetin.

Sigurisht duhet të jetë nji ndryshim në mes të nji djali i cili qyshë në vitët e para ká pá familjen e tij të ruejë e të nderojë fetarisht librat, e të nji tjetri qi e ká pá të bajë me libra atë ç ka bahet me këpucë të vjetra e rrobe jashtë përdorimit.

Ë mandej! Ç' ka janë ato q' i ringjallin má imtësisht e má ambëlsisht në zemrën e fëmisë familjen e largët ose të shpërdame, prindët e vdekun, dashtnin dhe kujdesjet me të cilat kje rethue? Li-

brat qi mbajnë emnin e babës, qi aj vetë vù në duerët e tija, për të cilat foli me të; i kujtojnë këndimet qi aj pëlqente, gjykimet e tija e shum sende tjera të natyrës së tij. Mbi disá libra i duket se sheh në dritën e qiriut të perkulem ato syza të shendritëshme dhe ajo mjekër e bardhë. Të tjerë i kujtojmë familjen e mbledhun rrethas, në heshtjen ndërsá njeni prej tyne këndonte, lëvizje njerzish të dashtun, brohoritje e qeshje gëzimi ose pshertima të pá vend të motrave të vogla, të cilat do t' i kishin dalë prej mëndësh ç' prej nji kohë të gjatë, lbiri i ati qi desh librat do t' i dojë librat e nuk ká me kenë kurr shpirt i keq aj në të cilin gjindet kjò dashtni

Të rrekemi prá qi t' a formojmë me kohë rreth nesh ket kunorë miqësh belbacakë e besnikë; të ndertojmë prá ket këshqjellë paqe kú do të kalojmë ditët në të cilat do të kapërthehem nga vuetjet e jetës.

Kto ditë do të vijnë e me to bashkë vjen edhe nevoja e vetmisë dhe e heshtjes dhe atëherë do të jetë e tristueshme mos pasja e nji qoshje shtëpije kú të strukemi qi të mund të harrojmë të gjallët tue u ngushllue me të vdekunit

E Përkthue

Xhabir Ismaili

V. D. V. \*38,

Prej ditarit t' im.

## Vajza e ligë.

Shkodrë 193 .. Në se cillen mbas dite, nder ditët e bukura të Majit të Frorit, në sa u këthejshe prej shkolle e në shpi e shifje per të giatë të rrugës. Kalonte e pshtetun për krah të nji grues qi mbas giase ishte e ama. Ecshin kadalë e nuk flitëshin.

Vajza ishte e giatë, e zbët në ftyrë, me dy sy të zez si qymyri, me nji shtat të

ndrej të dhe me flokë të verdhë e kaçurrel. Kùr u ndeshëshim rrugës, u shikojshim. Un dojshe me i thanë: "Xeju në diell o vajzë e ligë, thith ajrin e kulluet të natyrës e shndoshu.". E ajo tue i ulë syet e zez m'u bâte si të më thonte: "Shpresoj,."

Por në ftyrën e nanës u shifte një dhimë e pangushllueshme.

Mà nuk e pàsh vajzën e ligë, me ftyrë të zbtë e flokë kaçurrel.

Vall! Çë do të kët ndollë?

Në një mbramje, kalova afër shtëpis

së sajë. Népër dritore të çiluna për gjysë, delte një dritë e pakët. Ndoshta vajza do të jët shndoshë, e shpejt do të avitej afër dritsoreve për me i mbyllë. . . .

Ndoshta do të jën e ligë fortë. . . .

Ndëja për disa kohë e prita.

Prej dritores së çilun për gjysë, ndjeva një brimë të naltë dhe një uratë të preme prej lotësh e së kjamesh. . . .

. . . . Ishte urata e të dekunvet.

Lamtumirë o vajzë e zbtë, lamtumirël

Tomë Gjyshja.

Attilio Poncini. — Rivista di scienze applicate all' Ed. Fis. e Giovanile. Nr; 2, 1930.

## Randësija e lojës n' edukatën fizike të fëmivët.

Pjesa më e madhe e pedagogjistëvet qi janë marrë me lojën janë të një mendimi në të përkufizuem t' atij bashkimi aktivitete, qi prej natyre ka një farë grade t' inteligjencës, ka rrjedhur prej një energjije të mjaftë e si për të vetmin qëllim ka gëzimin.

E me të vërtetë, në qoftë se verejmë jetën e çfarëdo shtaze superiore, gjejmë simbas pjerrjeve të vetishme dhe të veprimi qi duhet të çfaqi n' ambientin në të cilin zhvillohet aktiviteti i sajë, ajo përdor energjit e veta, para së gjithash, në gjana të dobishme për individualitetin fiziologjik dhe për personalitetin e vet shpirtnuer e, vetëm mbassi t' i ketë përmbushë këto nevoja, po t' i teprojnë me shumicë, i shpenzon në gjana të gëzueshme, ose më mirë në lojë.

Zoqt p. sh fluturojnë përmes fushash ose zbresin nëpër oborre për me kërkue ushqim, bashkohen në grumbuj për m' umprojtë prej anmiqvet; por, kur nuk shofin ndonji rrezik ose kur nuk e ndijnë nxitjen e uris, shkojnë me kërcye e me luejtë mbi grunore, krejt si shkollarët t' onë të vegjël në kohën e pushimevet ndërmjet mësimesh.

Të gjitha shtazët e egra, po të gjëjnë ushqim ose gjah të mjaftë e të dobishëm, një pjesë të madhe të kohës së tyne e shpenzojnë në gëzime, sikurse edhe ato shtëpijaket, po të mos jenë zënë në punë të randa, shpenzojnë energjit e tepërme të

tyne në formë të gëzueshme. Kjo gjë vihet në çdo rast e nuk besoj të jetë nevoja për shembuj të tjerë.

Fëmijt e vegjël mandej, deri sa të jetojnë në kurris të prindvet, i kalojnë ditët tue luejtë; loja pra bân ball në moshën e parë të jetës.

Andaj është e natyrshme qi fëmijt t' onë, të lirë nga çdo ngatresë e jetës materiale, luejnë shumë më tepër se të mbëdhejt, të cilët duhet të përpiqen edhe për nevojat psikologjike e me plotsuem detyrat qi i takojnë gradës qi zënë në shoqni. Vetëm fëmijt e sëmundë nuk luejnë, sepse energjit e tyne janë dobsuem e, ata qi kanë organimin e dobët, luejnë më pak, mbassi atyneve u gelin pak energji të tepërta.

Mbassi e spjeguem këte pikë, qi loja nuk mund të prodhohet pa pasë një sasi energjije më të madhe se sa për nevojat e jetës, ndalem mbi një faktor tjetër: **aktivitetin psikik.**

Veç energjis fizike është e nevojshme një farë grade e inteligjencës, e njohnivët, d. m. th. një farë zhvillimi psikik qi të prodhohet loja.

Këte na e provon fakti se, sa më të zbresim në shkallën zoologjike, fenomenin i lojës paksohet deri sa zhduket krejt në shtazët pa inteligjencë.

Spencer-i këte gjë e var jo vetëm n' inteligjencën më të paktë, por edhe në punën më të madhe qi duhet të bëjnë

krijesat inferiore, për me përgatitë ushqimin e për m' u-mprojtë prej shumë më të fortëvet e anmiqvet më dinakë; punë qi shpenzojnë gadi gjithmonë energjit qi kanë.

Shtazët superiore, tue pasë një strukturë më të mirë, një numër më të math mundësisish, të pajosun me energji më të mbëdhaja munden me i kaluem më lehtësisht vështirësit për ruejtjen e eksistencës së tyne; rrethana të ndryshme mandej, tue vumë në stërvitje herë këte e herë ate fakultet, veprojnë në mënyrë qi disa prej tyne mbesin pa ushtrim për një kohë të mjaftë. Nga ky shkak ndoth qi kreatyrat e zhvillueme kanë një sasi fuqije qi është gadi gjithmonë e mjaftë për nevojat qi çfaqen e mjafton një rast çfaredo për me zhvilluem energjin e mbështjellun, qi gjindet në gjendje të pa pjekun e për me i lënë vend fenomenit të lojës. d. m. th ushtrimit shumë a pak të këtij a t' atij fakulteti qi nuk ka qenë përdorun në ndonji ushtrim të dobishëm, në ndonji punë.

Qi loja është më e përhapun e më e ndryshueshme ndër shtazët superiore, si pas inteligjencës së tyne më të madhe, provohet lehtësisht edhe me ato qi jetojnë afër nesh. tue bā krahasime ndërmjet lojës së njillojësme e të thjeshtë të mazit a të polishtit me ate të maces a të qenit e mbi të gjitha me të majmunit të mençëm e shumë të shkathët.

Ke njeriu po ai fenomen çfaqet më i dukshëm.

Fëmija nuk luen deri sa nuk ka zhvilluem cilsinat psikike e, në qoftë se për cdo arsye i pritët zhvillimi qysh muejt e para të jetës loja s' do të mund të prodhohet

**Sollier-i**, qi ka bāmë një studim të veçantë mbi hutaqët, thotë se tue hymë në mes të ktyne të mjerëvet, do të prekemi prej faktit qi, porsa t' u jepen atyneve shumë mjete dëfrimi, nuk kanë me luejtë veçse po të shtyhen e të nxiten prej mësuesve të tyne e shumë rrallë me dëshirë.

Kurse budallejt, ndër të cilët është ndaluem zhvillimi psikik vetëm ndër pjesa të veçanta, jepen mbas lojës, por ruejnë të metat e tyne e ndërmjet të gjithave pëlqejnë ato me zhurmë, në të cilat munden me gërthitë, me thymë ndonji gjā ose me qenë t' egër (brutalë).

Si mbaruem faktorët e nevojshëm qi prodhojnë lojën, do të përmend një tjetër qi ka randësi të madhe: **zgjedhjen e lirë.**

Nuk kemi lojë në kuptimin e vërtetë të fjalës, në qoftë se nuk ka liri e vetishmi veprimi

Fëmija dëfrehet me një copë karte të ngjyeme me bojë ose vetëm tue e ngritë prej toke, e në lojë përfytyron e mendon; t' i japim një kalë të vogël prej druje, një automobil të vogël dhe t' a detyrojmë qi të kalojë kohën në një mënyrë të caktueme me ato, do të shofim se ai do t' a lājë me zemër të thyeme rrokotelin e thjeshtë qi ka formuem vetë, do të vihët në dëshirën t' onë, porsa gëzimi në të nuk ka me qenë më, nga ky shkak lojë nuk ka me pasë më.

Mirëpo ai kalë e ai automobil herat e tjera kanë me shërbye për lojën e tij dhëfryese, kur t' i zgjedhi vetë e lirisht

Kështu qi për t' u-prodhuem loja janë të nevojshme:

- a) energji pak më shumë se sa për nevojat e jetës;
- b) një farë grade inteligjence;
- c) kjo energji e inteligjencë të mund të çfaqen me plot liri prej subjektit.

Tue qenë pra loja prodhim energjish fizike e psikike, rrjeth se ajo është edhe mjete për shtimin e ktyne energjiive. Përsëritja e veprimevet, qi plotson në lojë, shërben me ngulitë, me lehtësue, me i bā të zakonshme veprimet vetë, kështu qi ndoth, tue luejtë forcohen e përmirësohen fakultetet qi ushtohen, e lehtësohet fuqija e të lujtunit. Por fakultetet e ndryshme fizike e psikike nuk hyjnë në veprim të gjitha e po në një masë në të gjitha lojnat; në disa aktivitete fizike janë ushtruem më tepër, në të tjerat janë ato intelektualet qi ndërhyjnë më tepër; dhe lojna të tjera kërkojnë mandej mbi të gjitha vullnet, disiplinë, zemër, koordinim punimi etj.

Të ndryshme janë mandej nxitjet qi prodhojnë lojën e qi i japin karakteristikā e qëllime të veçanta.

Shkaqet e ndryshme, qi shkaktojnë të lejë loja e përdorimi në sasi të ndryshme të fakultetevet të ndryshme në lojna të ndryshme e si rrjedhje influencimi i tyne mbi aktivitetin e organizmit, i japin vend studimevet të veçanta e klasifikimevet të ndryshme.

Ky studim i pedagogjistëvet, fillosofëve e fiziologëve na bājnë të njofim se sa e gjānë është kjo fushë e se sa e nevojshme është një provë e kujdesëshme, ndën pikëpamje të ndryshme, për me mujtë me

vleftësue nji lojë.

Për sa kemi thanë shkurtas mbi faktorët e lojës përgjithësisht na bijnë në provë cilsit e lojës gjiniko-sportive, tue lënë pas dore të gjitha ato forma të lojës që nuk kanë randësi të veçantë për studimin t'onë.

**Spiro Shuteriqi**

## **Nder Vorreza.**

Nga i herë lëkundit telat e lyrës s'eme për me të këndue ty, o jetë plot gëzime e gazmende, e si je plot gazmende, kur shpesh herë të shiton e shum' nga rrugët t'ua zhduken në mes pyjesh t'egra?

Por, sado e fortë naltohet kënga, sado të përmallshme t'a báj me ambëlsin e jetës, edhe ajo, në fund, shkon e zhduket në vorr, plot zymnime e tristime.

Mike m'asht prandvera e lulzueme, e kah lulet e saja eci për m'u-gëzue; por ndërsa vegimi në kopsht ndalet, kambët më çojn në mes kryqash së vorreve.

Në heshtin e plotë rrethue prej fashës së vorrezave, lëshohem n'andrrat e vështira të zemrës; gjethet e akasjeve luhaten të përkunduna ambëlsisht prej fllimit të mrámjes.

Novelë

## **Zakoni?!**

Atë mbrámje në gjithë katundin dukej nji farë habije e gëzimi: për nji herë ishte marrë vesht fejesa e Mehmet Rrukës me Remzijen, të bijën e Sadik Plangut prej katundit t'afërm. Gratë e lodhuna prej punëve të ditës tash në mbrámje rreth kroit, ku mbushin ujë e qajnë të mira e të liga njana me tjetrën, ishin të parat që shoshin në këtë lajm:

— Moj, po si, Mehmeti?!; për atë patën thanë...

— Po dhe Remzija është vajz'e bukur...

Me të vërtetë kurkush s'e besonte këtë punë; të gjithëve u ishte mbushë mëndja se Mehmeti do të martohej me ndonji

Si shkrola të nji letres hyjnore rrijn gurët e vorreve, e mëndimet fisnike e bujare që lexoj, më joshin në thellsin e vorrit e prej kësaj më naltojn në qiell.

Plot trishtim ndie tingllimet e kumonës së fshatit. Do njerëz të ngrýsët hapin, atje posht, nji gropë të rë. Me nji vonesë të matun e të ngadalshme tingllimi i përmortshëm e shoqon në vdekunin në vendin ku do këthehet në baltë. Zemra e ime ka nji neshtrashë që me vështirsi e harron; s'ka me kalue shum kohë që, edhe mue, duart e atyne kanë me më plandosë këtu posht në vorr, e gjum' i përjetshëm i vdekjes ka me përshkue mbi syt e mij!

Tingllë n'emën të Zotit, në se me të vërtetë duhet të tingllojë ora që të këpusi të paskëtajshmen t'emel O shokë, merrni në grykë për herën e fundit atë që është e vdes bashk me gjith ato që pat trillue në dishiret e veta dhe fati nuk i lã kohë t'ia mbrrí. Qofshi shëndoshë! Edhë ju qofshi shëndoshë: ti, O dashni, lule që Zoti të ka zbritë prej qiellit; edhë ti, o lumni, hyll i shndritshëm i agimit, diell i shkëlqyeshëm i tokës.

**A. PETOEFI.**

E përktheu: Ihsan Podgorica

prej atyneve, që katundarët i quejnë flokëpreme; medje ai vetë, sa herë kishte qëllue t'a pyetshin moshatarët e t'afërmit, e kishte mohue martesën me vajzë katundi.

Gjithë kohën e rinis e kishte shkue ndër shkolla; edhe pushimet verore s'i kishte kalue gjithënji në katund. Ishte bëmë si i huej për atë vënd... Pleqt s'prájshin tue e lavdue; të rijt rucjshin për 'të nji, s'dij ç'farë, dashunije e nderim. Plakat e urojshin; të rejat e lakmojshin...

Ishte nji bukurosh njizet e tre vjeçar, ndër ata që malet t'ona dijnë të përgatisin. Kishte trup të mesëm e flokë të zeza; poshtë nji bálí t'ulët vijshin dy vetulla porsí

kunora, ndën të cilat mshifeshin 'syt e zi e përvëlues....

Puna kryesore e malsorit t'onë është martesja e djalit. Ndër katunde shumë fejesa bëhen qysh në djep....

Edhe Zenel Rruka, i ati i Mehmetit, ishte një malsuer si gjithë të tjerët. Ai ç'prej kohe ishte menduar për fejesën e të birit. "Të gjithë moshatarët e Mehmetit janë të martuem e edhe me fëmijë, i thonte shpesh e shoqja: Burr 'e grue s'kishin si me u përgjegjë fjalëvet të botës: "pse s'e martoni djalin?!, E vetmja arsye ishte se ai duhej të mbaronte shkollën, mbassi më parë nuk e lejojsin. Kështu kishte shpëtue Mehmeti....

— Por tash ai kishte një motmot që ishte nëpunës shteti; s'kishte si të gënjentë më. Duhej të merrrej një vendim.... E çfarë vendimi?: ju desh të plotsonte dëshirën e prindëvet, ju duhesh të pranonte mallkimin e 'tyne e të gjithë rrethit të afërmëve...

Me të vërtetë këjo është një ndër rasat më të vështira, që na paraqet luft 'e jetës, e kishin me mundë me e shprehë veç njëta, që kanë pasë fatin me e provue në kokë të 'tyne.

— Si të bënte Mehmeti?: si të vendoste?: Ç'prej shumë kohe ai ishte menduar me u përgatit për një zgjidhje t'arsyeshme të kësaj enigme, por as vetë, as rrethënat e jetës që kalonte, as mendimet e shokëvet s'kishin mundë me e sjellë në një vendim të premë... Kishte ngelë si një udhitari i lodhun në mes të fushës së pa fund, e disa mendime të largta, që rrallë përshkojnë në trut e të rijve, e kishin bënë pesimist..

— Ai kishte ndiem rrymat dallgëzuese të rinis.... Përpara bukuroshëve qytetare humbet çdo fije mendimi... Por dashnija për prindët, e sjellun ndër mend, i shtëngte çfarëdo drejtimi.... Asnjë këshillë s'vlente më për 'të; i ishte mbushë mendja se duhej të vendoste vetë....

— Dikur shkon me leje në shtëpi ka për rreth një grumbull të dashnish me një aso dashnija, që prek në telat më të holla të

zëmrës.... S'dij pse rrëmbetet shpejt prej kësaj melodije t'ambël dhe ja: është gadi të bëjë si t'i thonë....

— I u-bind zakonit për hir të dashtunisë prindore dhe atë mbramje ishte i fejuem, pse kështu po i thoshin.... I fejuem, po, me një vajzë, që as e njipte për fytyrë, as s'kishte pyetë për 'të, as s'kishte ndigjue dhe.... Herë, herë ndiente një shtërngesë shpirtnore e herë, herë s'donte me besue.. Donte, si thonë shumë, të përcjelli këtë ngatrrësë mëndimesh me një: "s'dihet si bëhet,...

— Atë mbramje e edhe për disa ditë s'pranë tue shkue miq e dashamirë, burra e gra për urim në shtëpi të Zenel Rrukës. Plaku e plaka pritshin t'ardhunit plot shënd, e djali i përcillte me një nënqeshje ircnike.... Disa këshillojsin Mehmetin që tash e mbrapa të bëhej edhe më kursimtar, se duheshin të holla për të marrë nusen.. Nusja do të blehej....



Sadik Plangu ishte ndër shtëpit e mira t'asaj krahine.

Remzija ishte më e bukura vajzë në katund. E kishin kërkue shumë për shoqe, por i ati s'e kishte dhënë; ndoshta kishte pritë Mehmetin?... Ishte në kohën më të bukur të vajzënis: shtatëmbëdhjetë prandërshe, e Zoti e kishte pajosë me gjithë të mirat, që mund t'i falij njeriut. Syt e 'saj të kaltërt me kthjelltësi të çuditshme kallzojsin një qartësi shpirtnore e me lëvizjet e 'tyne ndiellshin për gëzim dhe zemrat e zharituna; dy vetulla të holla dukeshin si mburojë e atij thesari. Flokët i kishte t'arta e të lëshueme përmbapa dallgëzueshëm pors i valët e ujit nën dritë të hënës.... Kishte hundë të drejtë, fytyrë të zgjatun, gojë me zatare, dy buzë të kuqe si qershi, që mbulojsin disa dhambë të bardhë; qafën të hollë, trupin të derdhun. Ishte pors i filiza e njomë, që din të zbukurojë prandëvera.... Plakat bëjsin për 'të: "Zot, fal-el, e djemt: "Zot, ep-mal,..." Por mbi gjithë këto dhurata të natyrës ajo ishte një vajzë katundi. Bota për 'të ishte e përbëme veç prej një asaj pamjeje, që i

lejonte orizonti. Kuptim 'i jetës: puno e hal.

— Ishte një katundarë. . . .

Djelmt e vëndit s'prejshin tue folë për Remzijen, për bukurin e vetijat e 'sajë.

— Dikush mund të kujtojë se dashtunija e ka vëndin veç ndër qytete, ku ndihen shpesh fjalët "amour," e "amore"; por s'asht e vërtetë; edhe katundarët e katundaret bijnë në dashtuni, medje në një dashtuni krejt të kthjellët, në një dashtuni të vërtetë, ku interesi s'ka as më të voglin vënd.

— Kishte ditë që dishka pëshpëritesh nëpër katund ndër goja të të rijve e të të rejave. Ishte marrë vesht se Osman Zhuri, po prej atij katundi, një djal që zihej në gojë për zotsi e trimni paska ramë në pje-kë me Remzijen. Shum habitëshin e s'dojshin me besue: disa të tjerë i brënte krymb' i zilis. . . . Kush kështu, kush ashtu, si bähët gjithëmonë për sëndet që s'u dihet e vërteta. Por Sadik Plangu s'kishte marrë vesht gjã. . .

Puna ngjanë kështu:

Osman Zhuri ishte ndër adhuruesit më të mëdhaj të Remzijos. Në shtëpi të vet kishte vetëm t'amën. Ishte djal guximtar e kishte bëmë mënd me bëmë gjithëshka për atë vajzë. . . .

— Ç'prej kohe tash më e kishte bëmë zakon me u gjindë çdo mbasdreke në Kodër të Lãmës kundrejt shtëpis së Remzijos. Aty, i ndëjun nën hijen e ndonji pëme, mëndonte veç për atë. Kah mbrámja shifej tue u'sjellë në rrugën, që të çon ke kroi i katundit, ku vashat e gratë shifen mbrámje e mëngjes tufa, tufa. . . . Këndej kishte marrë sa plagë zëmre e sa shkëndija lumnije të shpresueme. . . .

Ndër katunde t'ona gratë s'e kanë zakon me u-mshfë prej burrave e medje në shum vënde edhe flasin lirisht.

— Një mbrámje Osmani si gjithë herë po shetitë në rrugën e kroit. Së largu u duk tue ardhë Remzija, këtë herë për fat vetmaz, me ënët e ujit në dorë. Djali sa e pá ndjeu një të rrëshqethun të shtatit, e zëmra filloi t'i rrafë me shpejtësi. . . . Por edhe vajzës i u-skuq fëtyra qysh së largëti, e

dishka e fundi liqënin e qetë të zëmrs së 'sajë. . . . Edhe ajo e donte Osmanin. . . . , por. . . në katunde dashtunija ndrydhet prej zakonit. . . .

Djaloshi po i afrohej; ajo ndali hapin, uli kryet e dështi t'eci tue mbajtë krahun e majtë të rrugës.

— Remzije, ku shkton ?

— . . . . .

— Dëfto-më ku shkton ?

— Për. . . . ujë. . . .

— Po pse vetëm ?

— Ashtu . . . qëlloi. . . . sonde. . . .

— Remzije, dishka due me të thënë. . . .

Ndër kaqë djali i u-afroe dhe e rroku ambësisht për krah. Ajo u turpëue e s'bëzãjti. . . . Së largu ndigjohen disa zãna: ishin grã, që vijshin me mbushë ujë. . . . . Për këtë herë Remzija e Osmani e lanë me aqë. . . .

— Ata ishin takue dhe shum herë të tjera; e kishin nxjerrë turpin para njãni, t'jetrit e shka më tepër kishin dhënë besën. . .

Djaloshi ç'prej kohe kishte mënduem me e kërkue Remzijen për shoqe jete, por i ishte dukë një punë që s'bähesh, mbassi ai ishte pa pasje e pa krahë, si thonë katundësit. . . . Veç Zoti e dinte se si do të bähesh !. . .



Ah, atë të nesërme ! . . . . Atë të nesërme t'asaj mbrámjeje ! . . . . Në mëngjes nãna plot gëzim i afrohet së bijës për t'i dhënë unãzën e shamin e kuqe, që si mbas zokonit i dërgon dhëndërrin, i fejuemi.

— Remzije, bij'e ëme, vën-e në gisht këtë unãzë të bukur!

— Pse, nãnë, më ka blemë baba?!

— Po, po. . . .

Vajza merr unãzën, e provon ndër gishte dhe asht e dyshimtë; s'din si të thotë: . . . e bukur. . . . , por. . . . jo ! . . . ; i pëlqen edhe s'i pëlqen. . . . Mbas pak here nãna, tue e ledhatue me nj'atë mjeshtri, që u mëson instikti grave, i lëshon në krye shamin e kuqe. . . . Remzija atëhere kujtohet dhe jo: për një herë gjaku fillon udhetime të shpejta; ajo skuqet, turpënohet; he-

dh më një në unazën e m'anë t'jetër shamín. . .

Nuk ishte një rasë e jashtëzakonshme shka i ngjau nánës së Remzijas : të gjitha vajzat katundare kështu i mirëpresin dhuratat e para të shokëvet të jetës. . . Nga ndonji herë i përcjellin edhe me ndonji të game. . .

Remzijen mbas këtij mëngjezi s'e kemi më buzëqeshun. Nji farë melankolije, që aqë bukur dijnë të përcjellin syt e vashave, e ka kapllue. . . . Ajo vjen tue u shndrue dita me ditë. . . . Kur e tallin shoqet e vajzën is egërsohet; atyneve që i lavdojnë Mehmetin, këtë emër që tash e mbrapa s'duhej t'a zājë me gojë mbas zakonit, ju fal një pamje të menishme të përcjellun me nji t'ulun të kokës. . . . S'dinte ajo kush ásht ky Mehmet e ás s'donte të dijë. . . . I kishie dhënë besën Osmanit' nji 'atij Osmani që ándronte çdo natë. . . .



— Nji ditë të bukur vere paraqiteshin përpara Kryetarit të Komunes së vëndit nji djalosh e nji vajzë bukuroshe të djersifun e të pluhnuem. Në rrobet e tyne pasqyroheshin nji varg vucjtjesh e aratish. . . "Zakoni, thanë, na ka mundue! ". . .

— Po në këtë verë këndohej këjo shpallje ne derë të Komunes: Z. Mehmet Rruka martohet me Zonjushën Lirije Rroll prej qytetit X

Të dy çiftat rrojnë edhe sot.

Fruer 1937.

Selim Alliu

D. V. D. '33.

## Luigi Pirandello.

Më 10 Dhjetor, të viti që kaloi, vdiq n'Itali akademiku Luigi Pirandello, shkrimtar i shquar Italian.

Kishie lindur më 28 Qershor 1897 në Girgeut-i t'Italis. Mbas dështjes së t'et, i u-vu studimevet teknike, por shumë shpejt i

la këto e u-dha mbas studimevet klasike. U shkrojt, pra n'Universitetin e Romës në fakultetin e letrave, ku u-bë një nga nxënësit më të dashur të E. Menacit, profesor i filologjis romance n'atë Universitet. Mbas porosisë së profesorit të tij, më 1888 vajti në Böun për perfeksionim.

Si u-kthye n'Itali e tërhoqi jeta letrare dhe ajo e gazetaris. U njoh dhe u-bë mik me shkrimtarin Luigi Capuana, i cili e këshilloi Pirandello-n të shkruajë në prozë.

Në vitin 1904 i ndodhën fat-keqësira familjare dhe ekonomikerisht nuk gjëndej mirë.

Si e pa xhepin q'i u zbraz dhe hallet e jallanes s'kishin të sosur, u shtërngua të përfitojë nga diplloma.

U-ëmëruq, pra profesor i esthetikës e i stilistikës në Shkollat e mesme të Romës. Këtë detyrë e mbajti gjer më 1922.

Që nga viti 1929 ka qënë anëtar i Akademis Italiane. Në Nëndor të vitit 1934 fitoi çmimin Nobel në Letëratë.

Veprat e tij janë të shumta e të ndryshme. Ka shkruar shumë romanca e novela, vjersha e kritika letrare. Po veprat e tij theatrore janë më të shumta.

Shumë nga veprat e këtij shkrimtari të dëgjuar, janë përkthyer dhe në gjuhët e tjera.

Luigi Pirandello, dijt i shtjellojë e të thurë në novelat e dramet e tij, subjekte origjinale, me një fuqi mëndjeje që imponohet këndonjësit e publikut.

Të gjitha veprat pirandelliane janë të frymëzuara nga tragjedia e jetës. Ai ka dijtur të shpjerë në skenë tërbimin e pasioneve njerëzore dhe veprat e tij, me hovin e guximin e tyre, të fusin drithmë e hidhërim shpirti; të bëjnë t'interesohesh e të mallëngjehesh. ( V. N. )

### Bibliografi

Na erdhi në Redaksi komedia "Dhaskal Gjoka", e puntorit të palodhur Z. Ilo M. Qafëzezi. Përveç komedisë në fjalë libri përmban edhe disa shënime mbi shkollat dhe mësonjësit e parë Shqiptarë Këto shënime do të shërbejnë për Historin e Edukatës sonë Kombëtare.

## Fjalë të qëmtuara në rreth të Përmetitë me të kujdesurit të Zotit Pano S. Tase.

**Spicë** : cefëlë druje e hollë si gjilpërë; p. sh : Tek mernje drû më zuri një spicë në dorë.

**Stërbel** ( — li ) : sallbijë; Gjethen' e stërbelit' e përdorin' edhe në gjëllë, për t' i dhënë erë të mirë.

**Skamje** : papasje; varfërijë; vobegësijë.

**Selishtë** : yrt. kopëshitë brinjë shtëpijëse.

**Sgarbull** edhe **Xgarbull** : drû, lis me trungun' gllofë.

**Sgërbonjë** edhe **Xgërbonjë** : një me fjalën' sgarbull.

**Skërmisënj**, **Skërminj** ( dhimbëtë ) : kanosënj, frikësonj tuke kërcëlliturë dhëmbëtë; p. sh : Më skërmiti dhëmbëtë.

**Ckërmisënj** : një si spërmisënj.

**Sgjyrë** edhe **Xgjyrë** : palavijë; ndyrësijë; p. sh : M' ubënë rrobet' sgjyrë ( nga të palarëtë ); I qe bërë qafa sgjyrë.

**Shtjeskë** ( — ka ) : shortare; grua që sh'jen ( që sheh ) fatinë; grua që rrëfen ( që kallzon ) fatinë

**Shqeskë** ( — ke ) : një si shtjeskë

**Shuplik** : kucubiq; shkurtabiq; njeri i shkurtërë nga shtati.

**Shtërmbanik** : shtërmbanuk; njeri i shtërmbërë në trup; shtërmba

**Shoshkë** ( sidomos në shum. shoshka ) : mbeturina të shoshësë.

**Shkarzimë** : shkarrëzimë; tokë e prierë pa bima e pa gurë ku ven' e shkarrëziten' ( shkasinë ) vegjëllija.

**Shakull** : kacek; kaçup; lëkurë e punuarë dhe e qepurë si thes. për të mbajturë ( për të mbarturë ) djathë, gjalpë, vajë, verë etj.

**Shparsë** ( — sa ) : kuletë e leshtë, e thurur' si çorape, me grykë të ngushtë ngaha ku shtjenë brënda një halë sapoji, për t' ufërkuar' e për t' ularë në banjë të trupitë; shpallxë.

**Shparsonem** : fërkohe me shparsënë mbë t' ularë trupinë.

**Shqerzohem**, **Shqerzonem** : humbasënj nderinë; më prishetë nderi; bjenj nga nderi; p. sh : Lër-e se ushqerzua ay njeri.

**Shqerëzuarë** ( i — ) : i humburë nderinë; i rënë nga nderi; cipëplaturë; njeri që s' din mëë ç' është turpi.

**Shqerëzim** : të rënë nga nderi; të plasurë cipa e turpitë.

**Shajkë** : peronë, goshdë e vogëlë.

**Shurdhavel** ( fem. shurdhavele ) : i shurdhë; i rëndë nga veshëtë.

**Shushavel** ( fem. shushavele ) : i shushaturë; i hutuarë; i mbeturë.

**Shtarë** : helëmë; p. sh : gjëlla qënëka bërë shtarë me kripë.

**Shtaronj** : helmonj; apënj shtarënë ( helminë ); p. sh : Shtarë të shtaroftë ose shtarohu të shtaroftë ( si mallëkim për ndonjë që han shumë, që kërkon të hajë koh' e pa kohë ); Hëngërm' e ushtarua më ( në kohë helëmi; po edhe në kohë pasasje si me thënë hëngërm' një kothere buke të zezë, të thatë ).

**Shkrump** ( — mbi ) : të djegurë krejetë; të bërë si thënjgji.

**Shkrumbiturë** ( i — ) i djegurë i bërë thënjgji; i nxirë së djeguri.

**Shtypës** : popërë guri, zallë i rrumbullakëtë për të shtypurë kripënë.

**Shugatë** : jam mbë t' ushuarë, mbë t' ufikurë për zjarrinë.

**Shugaturë** ( i — ) që është e fiketë, e shuhetë për zjarrinë.

**Shtyranik** : i pjellë para kohësë.

**Shëndrinj** : mbahe m kryelartë; bënj pas kryes', pas mëndjes' së vehtë; p. sh : Përse të mos shëndrinjë, ka gjetur' stan pa qen; Do-e-mos shëndrijë'n' nuset' tashit', thonë plakatë, kan' gjetur' shesh' e bëjën' përshesh,

**Shkumëngarë** : i ngarë nga ajo e tokësë; që e zën sëmunda e hënësë ( e herësë ); Gratë e përdorin' më shumë si për qertim, si për përcëhim, si për mallëkim, p. sh : Ay shkumëngari që mos qoftë.

**Shkumë** ( — ma ) : sëmunda, puna e hënësë ( e herësë; e tokësë ); p. sh : E ngaftë shkumia ( për mallëkim; e zëntë, i raftë ajo punë, ajo e herësë ).

**Shqekëzë** : në mënyrë që të sgjidhetë lehëtë, për fijetë, për gjëlmënjëtë etj. Është mënyra e kundërt' e piskutë; p. sh : Mos i bëj pisk gjalmitë po lidh-e shqekëzë ( domethënë tuke i lënë një vesh që të shthuretë të lidhuritë ).

**Shtjekëzë** : një si fjala shqekëzë.

**Shtërzonom** : jam në të pjellur' e sipërë, për kafshëtë; mundohem në të pjelluër, për kafsnëtë.

**Shuallë** : shtruarë; në mënyrë që të mbulonjë vëndinë; p. sh : Ranë gjithë dardhëtë shuallë për tokë; Gjethet' kishin' rënë shuallë për dheë.

**Shdrinj** edhe **Shdërinj** : shdërrinj ( shthurënj ) çorape, pëlthurë, sende t' jera të thurura.

**Shushallë** : shushavë; shkretëtirë; vënt i thatë; p. sh : I dha djalit' shushallatë ( e përzuri nga shtëpia, e dëboji ).

**Shark** ( — rgu ) : një si brucë; sharkë.

**Shushk** ( — ku; fem. shushkë ) : i hutuarë, i shushaturë nga mëntë; i mbeturë; shushavel; zhuzhgë.

**Shanik** ( fem shanike ) : një si shushk.

**Shanuq** ( fem shanuqe ) : një si shushk.

**Shtihetë** ( më — — ) : më teketë; më shkon mëndja për një gjë; më vete ylli (hylli) për një gjë; p. sh : M' ushty për . . . .

**Trim Fshati** ( Trimi i fshatitë ) : ruajtës i cili përveç kujdesës' për arat' dhe vreshtat' të fshatitë ishte dhe për të përsjellur' fshatarëtë nga një vënt në t' jetrinë; në kohë frikërash prej kusarësh; pëndar.

**Trirë** ( — ra ) : derë vathi o gardhi e thurur' me purteka shelgu, me thupëra xane etj.

**Tororinj, Tororisënj** : hedhënj e përhedhënj ndëpër duarë një gjë, një foshnje; p. sh : E gjeta teku torororiste foshnjënë.

Përdoret' edhe kur është puna për ndonjë fjalëshumë o gjuhëngëthurë që nuk' i a gjen fundin' fjalësë; p. sh : Mjaftë e torororise, thuaj-e ç' ke për të thënë.

**Tirretë** ( më — — ) : duanj; kam mall; më han malli; i vinj rrotullë njëj sendi, njëj' pune që s' ka për të dalurë mbarë; p. sh : I tirret' për të rrahurë ( i han gjaku, kurrizi për t' urrahurë; don dru; i zjen gjaku për kopaçe ).

**Tërvilëmë** ( i — — ) : i tërvitëmë; i prej tre vjetësh.

**Tarbosënj** : gëdhinj ( rjepënj; shkundënj ) në lodërë; p. sh : I tarbosi gjithë shokëtë në kartëra ( në xhime; me xhime ).

**Tarbosurë** ( i — — ) : i gëdhirë ( i gëdhjiturë ) në lodërë; i humburë gjithë ç' kishte; i mbeturë pa një ovullë në lodërë.

**Tarbë** ( — ba ) : të gëdhjiturë në lodërë; të rjepurë ( të shkundurë ) në lodërë; p. sh : Na i bëri tarbë të gjitha ( na i fitoj' të gjitha në lodërë; na la pa një dyshe ).

**Troçkë** : copë; thërrime; trokë; vrma-vrma; p. sh : Na ubënë enëtë troçkë ( trokë ).

**Telikosurë** ( i — — ) : i këputurë; i kapiturë; i dobëtuarë.

**Telikosënj** : këpusënj; rrëgjonj; dobëtonj; kapisënj.

**Turvasënj** : kollofinj; hanj gjithë sa janë përpara; përlanj; p. sh : I turvati gjithë mollëtë

**Torrovasënj** : një si turvasënj.

**Turuvasënj** : një si turvasënj.

**Torombol** dhe **Torrömbol** : njeri i trashë ( i mpitë ) nga mëndja, që nuk kupëton lehtë.

**Toroman** dhe **Törroman** : një si torombol.

**Trullonj, Trullosënj** : hutonj; shushasënj nga mëntë.

**Trullosurë** ( i — — ) : i hutuarë; i shushaturë.

**Upëtuarë** ( i — ): i motuarë ( sidomos për bukë ); p. sh : Bukë e upëtuarë ( bukë e ndenjurë, e vjetërë ); Upëtua buka ( buka ubë shumëditëshe ).

**Uruvejkë** : furruvejkë.

Njeri ( dhe sidomos grua ) dhënë pas punësë me mish e me shpirt; p. sh : E ka bërë Perëndija uruvejkë ( nuk' e zën gjumi për punë ).

**Ujakës** : të qarë pa pushim dhe me zë të math; p. sh : Ç' i ka hipurë ky ujakës këtij' të ziu ? thonë gratë për ndonjë foshnje që nuk pushon së kujituri.

**Therishte** : ferishte; i vogëlë i pa djallëzuarë, i paligësijë në zemërë; i miturë, zemërëmiturë; shpirtmiturë.

**Thuthuq** : thuthuq; njeri që nga të mbajturit' të gjuhësë nuk' shqipton mirë tingëllin' S të cilin' e bën si TH.

**Vuratë** : vurratë; vrajë; brajë; mbresë; shënjë plage të vjetërë.

**Vagjëlijë** : të rrojturë mirë; të ngrënë mirë; p. sh : Akëcili rron me vagjëlijë; I sëmuri don vagjëlijë sa të shëndoshetë; Pleqërija don vagjëlijë.

**Vagëllonj** : nuk' shofënj mirë nga sytë. Kapshallinj ( mbëllynj për gjysëmë ) sytë ( nga dëshira, nga lakmija ) etj. Venitem për dritënë; p. sh : Ky njeri vagëllon nga sytë ( nuk' shef mirë nga sytë ); Ti hëngre, uçupite këtu ( udëndë këtu ) po ay vagëllon atje ( po ay mban barkun' me dorë atje ); Kandileja vagëllon ( kur nuk' bën me aftë dritë, kur është mbë të fikurë ).

**Vervele** ( — ja ) : ves i rëndë; tengë; monomanijë; p. sh : M' ubë vervelë kjo gjë ( më ka mbetur' si tengë ndër mënt; m' ubë si sëmundë ); M' ubë vervelë duhani, cingari

**Verojkë** : verore; fije leshi 3-4 njëgjyërash, që ( sidomos çupatë ) lidhin' në rrzëzë të dorës' së djathërë ditën' e verësë ( 1 Mars ) si rruazë kundër' ethevetë ose për të pasurë shëndetin' të pacenuarë gjatë vititë, ose për mos të pasurë benga në fytyrë nga zhegu i djellitë. Verojkat' i mbajën' gjer mbë të ardhurit të dellëndyshevetë dhe atëherë i mvarin' nga ndonjë degë që t' i marin' dellëndyshetë për të ngrëhur' folenë ose për t' i hedhurë në det si ç' e besojën' njëjetiu.

**Varavingë** : të vajtur' e të ardhurë pa pushim; të vajturë tutj' e t-hu posht' e lã, posht' e lartë; të sjellurë çap e eja ( çap e jak' ); p. sh : Ç' vete kështu varavingë ?

**Veshëllapush** ( fem.—she edhe—shkë ); i me veshë të mëdhenjë, të gjërë si llapa.

**Vixgonj, Vixgosënj** ( visgônj; visgosënj ) : mbushëj plot' për buzë; mbushënj llëckë; p. sh : I kishte vixgosur' gjymat' me ujë; Mos e vixgos qypin' se derdhetë.

**Vervinj, Vërvisënj** : hedhënj largë; sjellënj largë; p. sh : I vërviti një gur ( i shtyri së largu me një gur ); I a vërviti në sy ( i a ndërlyti; i tha një fjalë të papëlqyerë në sy. në faqe ).

**Vërvitem** : hudhem; turrem; p. sh : Uvërvit nga muri ( hodhi vehtenë, uhoth nga muri poshtë ); I uvërvit ( i uturr; i uderth ).

**Vjedharak** : që vjedhën; që ka për fisi të vjedhuritë; që ka në gjak kusarijënë.

**Veshëshpuarë** : i pjekurë; i rëgjurë; i kupëtuarë; i mësuarë; i hollë; që din ( që ka mësuarë ) shumë sende të jetësë ( nga jeta ).

**Vëngarash** : syll; ndopakë i vëngërë, i vangëtë.

**Vlak** ( — gu ) : lënk; njomësijë; lagështijë; p. sh : Tokë pa vlak ( tokë e thatë, e djegurë, që s' i ka mbeturë hije lagështije ).

**Vulërë** ( — ri ) : bar i egërë që rritet' si fshesë; krisje e gjatë.

**Vashdë** : vijë ( gjurmë ) e thellë; p. sh : I rashë pas vashdësë.

**Virok** : lesh i tjerrurë, i bërë dredha, turra; lesh' i tjeirur' po i pa bërë lëmsh; i shtruarë dredha dredha.

**Vilar** : top pëlhure; pjesë pëlhure.

**Zallajjë** : pëshjtëllim; zhurmë; zallahijë; zallamahijë.

**Zimbicë** ( — ca ) : ?

p. sh : I ka rënë zimbica ( nuk' i pritëtë, nuk i durohetë sidomos për të ngrënë ); Prit pakë se nuk' të ra zimbica.

**Zabanë** ( sidomos në shum. zabana ) : shtëpija të mëdha; pallate.

**Zokth** ( — thi ) : tuli i krahutë; pulpa ( e trasha ) e krahutë.

**Zallishte** : tokë plo' me zeje përanë buzëvet' të lumenjëvetë.

**Xhangallë, Xhangelie** : vegëlë tepër' e madhe, e gjatë ( sidomos për vegëla me presë, sëpatë, thikë etj ); p sh : Ç' e deshi gjith' atë xhangales-thikë në bres; Kishte një thikë sa një xhangalle.

**Xhongalië, Xhongalle** : një si xhangallë.

**Xharballë** ( — lla; sidomos në shum. ) : të ndërkyerë; të tërhuzurë; të dalurë mëndësh nga zemërimi etj p. sh : S' munda t' i bënj fjalë se i kishin' rënë xharballatë.

**Xharballosem** : më hipën të ndërkyerëtë: bënj ( bëhem ) si i tërbuarë, si i dalurë mëndësh.

**Xhumbëlë** : xhumbë; xhungë; xhongë; xhongëlë; p sh : Vrava kryetë pas trarit' e m' ubë xhumbël' në ballë.

**Xhuvele** ( — ja ) : degë e vogëlë druri e ngarkuarë me pemë

**Xgardhallomë** : shkatërrirë; gjë e shkatërruarë; p. sh : Një xgardhallomë shtëpijë ( një sht-pijë e shkallmuarë, e shkatërruarë ).

**Xgardhallonj, Xgardhallosënj** : shkatërronj; shkallmonj; p. sh : Na xgardhullan' shtëpijë ( na prishën' shtëpijë ).

**Xërbë** ( — ba ) : dele o dhijë plakë e pa vleftë sepse nuk' ka si mahetë.

**Xgjypënj** : ngopënj ( sdëpënj ) së rrahuri; rrëgjënj së rrahuri; ngopënj me dumka ( me grushta ); p sh : E zgjypëa' akëcilinë.

**Zhymbëlë** : popëlë; gur i math; popërë guri.

**Zhakëminj, Zhakëmisënj** : labërkosënj; bënj si lëvere një gjë; thuhet' sidomos për mishë; p sh : Po zhakëmit një copë mish ( dredh' e përdredhën në gojë një copë mish, sepse nuk' i punojën' dhëmballëtë ). Na uzhakëmitën' duarëtë ( na ubënë duarëtë giak. plagë nga ndonjë pun' e rëndë ).

**Zhakëmiturë** ( i — — ) : i grirë, i prerë, i copëtuarë me thikë të pamprehurë; i bërë si lëvere. sidomos për mishëtë.

**Zhurë** : mëllë ( plënk në zemërë; pikëllim i math zemëre, shpirti. sidomos kur nuk' harrihet' një qëllim, një dëshirë; p. sh : Shkoj' zhurë i shkreti ( vdiq nga e keqeja ).

**Zhuritem** : digjem, përvëlohem. pëlcasënj nga pikëllimi, nga helm; zhuritem.

**Zhuriturë** ( i — — ) : i djegurë, i përvëluarë, i përcëlluarë në zemërë, në shpirt; i zhuriturë.

**Zhurepsem** : digjem, përvëlohem me zjarr o me jetër' sent të nxehtë, të valë; p. sh : Akëcili uzhureps me gjëllë

**Zhurepsurë** ( i — — ) : i djegurë, i përvëluarë me zjarr o me gjë të valë.

**Ylli** ( më vete ylli për . . . ) : një si lektisënj.

**Bushtërë** ( — ra ) : femëra e qenitë, sidomos shtatëmadhe që mbahet' për rojë.

**Memec** : njeri që i mbahetë goja.

**Gjolle — Gjolle** ( sidomos fjalë bujqësije ) : troje-troje; vatra-vatra; vëndë-vëndë; thuhet për farënë që diku ka birë e diku jo.

**Bistërë** : kristal; p. sh : Akëcili është i shëndoshë si bistërë.

**Kiliz** : kizili; kij zilijë: fjalë vegjëlijësh kur duan' të mburren' faqe shokëve tjerë; bicë.

**Grykëzë** : copë pëlhure e snejtur' me penjë të bardhë që përdorin' plakatë në vënt të këmishësë; parzëmë këmishë.

Gushore për foshnjëtë për mos t' urekosurë për mos t' ubërë me jargë.

**Njgjepënj** ( i a — — ) : i a qepënj; e qëllonj; e goditënj; p. sh : I a njgjepi me gur koksë.

## Posta e Jonë.

- Z. Ndoc Fishta — Gjirokastrë. Do të botohet.  
Z. I. Pali — Qeparó. Shkruani diçka tjetër.  
Z. Sadi Pejani — Ersekë. Muarmë. Do të botohen. Të fala.  
Z. A. Andriku — Tiranë. Shtyhet për më tej.  
Z. Gj. Shota — Ersekë. Muarmë. Do të botohet së afërmi.  
Z. R. S. Frashëri. Nuk botohet.  
Mësuesit — Burel. Mbetet për numërin që vjen.  
Z. S. Papparisto — Gjenève. Nga mungesa e vëndit, artikulli mbi Institutin mbeti për numërin që vjen. Të fala.  
Z. P. Serjani — Pogradec. Nuk është dhe aqë e rjedhëshme.  
Z. Gavril Santo — Kolonjë. Shtyhet për më tej. Të fala.  
Z. K. Ylli — Lyon. Muarmë. Do të botohet. Të fala.  
Zonjushës Drita Hajro — Gjirokastrë. Muarmë të hollat që na dërguat. Të fala.  
Z. Z. Spasse dhe Gusho. I kemi marrë. Të fala.  
Z. Isak Ngurrëza. Muarmë të hollat. Presim dhe të tjerat sa më parë. Të fala.

Me qënë se na kanë ardhur shumë shkrime disa nuk u-shqyrtuan dot këtë herë. Përgjigjet në numërin që vjen.

Të gjithë ata që marrin të përkoheshmen t' onë, jo nga përfaqësonjësit, por drejt për së drejti, janë të lutur të na dërgojnë pajtimet sa më parë. Na nuk kemi ndonjë thesar të grumbulluar këtu që të mos kemi nevojë për të holla. Presim.

### Ndreqje gabimi.

Në numërin që kaloi në titullin e një artikulli është thënë gabimisht: Dobia e Mësimit në periudhën e njomë, kurse duhet thënë " Dobia e ushtrimit „.

